

MISIONI

Misioni ynë është që të zhvillojmë dhe avancojmë një organizatë profesionale dhe konkurruese edhe në tregun ndërkombëtar, e cila përmbush standardet më të larta profesionale dhe etike, si dhe perfeksionon performancën organizative përmes menaxhimit financiar, sigurisë dhe ekspertizës së specializuar. Ne veprojmë me integritet, objektivitet dhe me përkushtim ndaj cilësisë dhe interesit publik.

VIZIONI

Vizioni ynë është të bëhemi prijës në krijimin, vlerësimin dhe interpretimin e informatave, të cilat masin dhe avancojnë performancën organizative, duke pasur për synim ofrimin e zgjedhjes sa më të mirë të menaxhimit financiar, sigurisë dhe shërbimeve tjera të specializuara.

QËLLIMI

Zhvillimi i vazhdueshëm i programit të trajnimit i krahasueshëm me programet e shoqatave profesionale më eminente të kontabilitetit. Zhvillimi dhe avancimi i bazës së anëtarësisë të njohur për ekspertizë profesionale dhe standarde të larta etike. Anëtarësimi në organizata profesionale ndërkombëtare.

Përmlledhja

ShKÇAK – Prijëse në krijimin dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale.....	5
Fjala e Kryetarit	6
Mesazh nga Drejtoresha Ekzekutive	8
Aktivitetet dhe puna e ShKÇAK gjatë vitit 2015.....	10
Kualifikimet profesionale të ShKÇAK ekuivalente me kualifikime globale.....	15
Edukimi i vazhdueshëm profesional (EVP) i domosdoshëm për të qenë në hap me trendet e zhvillimit të profesionit	22
Shërbimi për anëtarë prioritet për ShKÇAK	25
Shpallja e studentëve të dalluar nxit ngritjen e nivelit të performancës	27
Përfaqësimi i ShKÇAK në nivel Vendor, Rajonal, dhe Ndërkombëtar.....	28
Mbrojtja e interesave të anëtarëve përmes avancimit të profesionit të kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë.....	34
Raportet nga komisionet e ShKÇAK.....	38
Raport nga Komisioni për Nominime	39
Raport nga Komisioni për Sjellje dhe Disiplinë.....	41
Raport nga Komisioni për Edukim Profesional	43
Raport nga Komisioni për Edukim Profesional	45
Raport nga Komisioni për Standarde Profesionale	47
Raport nga Nën-Komisioni për Tatime	49
Statistikat e vitit 2015	50
Pasqyrat financiare dhe Raporti i Auditorëve të pavarur	55

Lista e shkurtesave

AL (CPA)	Auditor i Licencuar
ATK (TAK)	Administrata Tatimore e Kosovës
BE (EU)	Bashkimi Evropian
BSNEK (IAESB)	Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Edukimit dhe Kontabilitetit
BSNKSP (IPSASB)	Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik/LFPK (CIPFA) – Instituti i Licencuar për Financa Publike dhe Kontabilitet
DOA (SMO)	Deklaratat e Obligjimeve të Anëtarësisë
DShA	Departamenti i Shërbimit për Anëtarë
EVP (CPD)	Edukimi i Vazhdueshëm Profesional
FEKA (FEE)	Federata Evropiane e Kontabilistëve dhe Auditorëve
FNK (IFAC)	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve/Auditorëve
IAAÇP (AICPA)	Instituti Amerikan i Auditorëve të Çertifikuar Publik
IAL (HEI)	Institucionet e Arsimit të Lartë
IEK (NBA)	Instituti i Ekspertëve Kontabël të Holandës
IKPAJ (SAIPA)	Instituti i Kontabilistëve Profesionistë të Afrikës së Jugut
IPK/A (IPA)	Instituti Publik i Kontabilistëve/Auditorëve
KBK/A (WCOA)	Kongresi Botëror i Kontabilistëve/Auditorëve
KKIKAÇ (CNDCEC)	Këshilli Kombëtar Italian i Kontabilistëve dhe Auditorëve të Çertifikuar
KKRF (KCFR)	Këshilli Kosovar për Raportim Financiar
KLSH (SSA)	Kontrolli i Lartë i Shtetit i Republikës së Shqipërisë
KZhOPK/A (PAODC)	Komisioni për Zhvillimin e Organizatave Profesionale të Kontabilitetit/Auditimit
MMFKPB (MOSAIC)	Marrëveshja e Mirëkuptimit për Fuqizimin e Kontabilitetit dhe Përmirësimin
NVM (SME)	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
ONISA (INTOSAI)	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
OPK/A (PAO)	Organizatat Profesionale të Kontabilitetit dhe Auditimit
QRRF (CFRR)	Qendra për Reformimin e Raportimit Financiar e Bankës Botërore
REPRKFI (REPARIS)	Rruga drejt Evropës: Programi i Reformës në Kontabilitet dhe Forcimit Institucional
RRSK (ROSC)	Raporti për Respektimin e Standardeve dhe Kodeve
SNA (ISA)	Standardeve Ndërkombëtare të Auditimi
SNE (IES)	Standardet Ndërkombëtare të Edukimit
SNISA (ISSAI)	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
ShAÇA (ACCA)	Shoqata e Auditorëve të Çertifikuar të Anglisë
ShKÇAK (SCAAK)	Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës
ShTK (AAT)	Shoqata e Teknikëve të Kontabiliteti, Britani e Madhe
UBT (UEBT)	Universiteti për Biznes dhe Teknologji
ZAP (OAG)	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

ShKÇAK – Prijëse në krijimin dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (ShKÇAK) është organizatë profesionale e cila i ka krijuar vetes një hapësirë të vlefshme në shoqërinë kosovare duke themeluar programin e parë të edukimit për profesionin e kontabilitetit në Kosovë dhe duke vepruar në përputhje me standardet ndërkombëtare të edukimit dhe trajnimit, rregulloret vendore, si dhe direktivat e kontabilitetit dhe auditimit të dala nga BE.

Misioni ynë është që të shërbejmë në interes të publikut duke krijuar dhe zbatuar standarde që sigurojnë profesionistë të kualifikuar në kontabilitet, raportim financiar, auditim dhe fusha të menaxhimit financiar. Me misionin për t'i shërbyer interesit publik, ne kërkojmë jo vetëm të përfaqësojmë kontabilistë dhe auditorë, por edhe të adresojmë nevojat dhe boshllëqet e Kosovës që pengojnë vendin drejt zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.

SHKÇAK tregon përsosmëri nëpërmjet kualifikimeve të saj dhe vepron si një forcë shtytëse në kuadër të profesionit të kontabilitetit për të përmirësuar vazhdimisht praktikën e punës. Duke qenë anëtare me të drejta të plota e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Auditimit (FNK) dhe Federatës Mesdhetare të Ekspertëve të Kontabilitetit (FCM)

e posaçërisht anëtare e Komisionit të Zhvillimit të Organizatave Profesionale (PAODC) në FNK, përfaqësuesit e ShKÇAK kanë kontribuar në zhvillimin e udhëzuesve për krijimin e organizatave të tjera profesionale si dhe programeve certifikuese kudo në botë.

ShKÇAK përfaqëson rreth 6000 anëtarë të cilët janë të angazhuar në sektorë të ndryshëm në institucione kyçe të Republikës së Kosovës, siç janë Banka Qendrore, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, Presidenca, Zyra e Kryeministrit, Ministritë, Komunitet dhe bizneset dhe firmat e auditimit.

Prandaj, ShKÇAK konsiderohet një shoqatë në progres e cila punon për ngritjen profesionale të anëtarëve të saj dhe mbrojtjen e interesit publik duke kontribuar në zhvillimin ekonomik të vendit.

Shoqata ofron specializime në lëmi të ndryshme me qëllim që të krijojë kapacitete profesionale të nevojshme për kontabilitet dhe auditim në sektorin privat, publik dhe auditim të brendshëm.

Fjala e Kryetarit

Të nderuar kolegë,

Si profesionist, nuk kam dashtë të jem vëzhgues, kam tentuar që të jem dhe veproj aty ku janë zhvilluar ngjarje të rëndësishme për profesionin dhe kjo është ajo që më shtyri të kyçem në shoqatë, komisione dhe strukturat drejtuese.

Miq të respektuar, ju ftoj që të bashkoheni.

Ndiqui instinktin dhe interesin me energji të vërtetë dhe vetëbesim, shumica e gjërave janë të mundshme. Me atë rast është me rëndësi të mbani në vëmendje synimin e qartë të cilin tentoni ta arrini, por mos lejoni ti injoroni tjerat mundësi me rëndësi të njëjtë, që mund të ju paraqiten.

Kur jam zgjedh si nënkryetar dhe pastaj e kam pranuar postin e kryetarit, kam pas ide për profesionalizëm, etikë, moral dhe drejtësi, kam insistuar për rikthim kah interesat e anëtarësisë, për konkurrencën që pona vjen, kohërat e krizës së moralit dhe dominimit të interesave personale, mungesës së afarizmit të ndërgjegjshëm, mungesës së moralit dhe ndershmërisë në biznes dhe shoqëri në përgjithësi, e këto të gjitha i kam pa si rrezik për emrin të cilin e gëzon edhe pozita në profesion që e ka arrit deri tani shoqata dhe anëtarët e saj.



Sot është koha në të cilën duhet të projektojmë të ardhmen. Mos të harrojmë se e kaluara vlerësohet edhe me atë se si dhe sa kemi arrit t'i shfrytëzojmë mundësitë të cilat na u kanë dhënë.

Ne si prijës në profesion e kemi strategjinë afatmesme të zhvillimit të cilën vazhdimisht duhet ta zhvillojmë dhe përditësojmë, veçanërisht kjo i takon drejtuesve të rinjë që do të marrin përsipër planifikimin e zhvillimit të shoqatës dhe profesionit për dy vitet e ardhshme. Ndoshta nuk duhet pritur një projekt krejtësisht të ri, por kam pritshmëri për gatishmëri të drejtimit të ri që menjëherë të bashkojë forcat kreative nga radhët e anëtarësisë për planifikimin e të ardhmes së shoqatës dhe profesionit. Personalisht, jam i bindur si dhe anëtarësia e gjerë, dëshiron që koncepti zhvillimor i shoqatës dhe profesionit të jetë rrugë kah një shoqatë dhe profesion edhe më i suksesshëm.

Kam bindjen se shoqata do të vazhdojë, që anëtarëve të vet, t'u sigurojë nivel edhe më të lartë të vlerësimit në bazë të profesionalizmit, etikës, moralit dhe përkushtimit e kjo do të jetë rrugë për ngritjen e emrit të shoqatës në nivelet më të larta profesionale.

Interesi ynë duhet të jetë e ardhmja e shoqatës pasi që ne, së bashku me gjeneratat që vijnë, edhe në të ardhmen do të jemi aty anëtarë të saj.

Humbësit jetojnë me të kaluarën. Triumfuesit mësojnë nga e kaluara, kënaqen duke punuar në të tashmen, duke ndërtuar të ardhmen.

Me respekt,

Shaban Muharremi
Kryetar i Këshillit të ShKÇAK



■ Nga e majta: Nazmi Pllana, Melita Ymeraga, Ariana Salihu-Rozhaja, Shaban Muharremi
Mungojnë: Shyqiri Bytyqi, Sakip Imeri, Ibrahim Gjyldereri

Mesazh nga Drejtoresha Ekzekutive

Të nderuar anëtarë,

Të jesh lider në një vend që është duke kaluar nëpër procese të shtet ndërtimit është një prej sfidave më të mëdha të një organizate. Por, ne - ShKÇAK e arritëm këtë.



Tanimë ne nuk jemi vetëm liderë të profesionit brenda kufijve të Kosovës, por edhe jashtë saj, me vet faktin që për vetëm 15 vite të ekzistencës kemi arritur të jemi pjesë e zhvillimeve globale, të jemi shembull për vendet e tjera dhe të dëgjohet zëri ynë.

Kjo na bën të mburremi për të gjitha zhvillimet, por a na bën të ndihemi njejtë edhe në vendin tonë i cili me ose pa dashje nuk e kupton rëndësinë dhe ndikimin e profesionit në zhvillim ekonomik dhe luftën kundër korrupsionit. Mos edukimi i mirëfilltë dërgon deri te mos-zhvillimi. Si ShKÇAK, kjo është vlera të cilën e kemi arritur që Çertifikata jonë të jetë e vlerësuar, asnjëherë dhe për asnjë kusht kjo shoqatë nuk ka lejuar që të diskreditohet vlera e saj.

Ju që mbani Çertifikatë të ShKÇAK-së jeni e ardhmja e zhvillimeve të mirëfillta të shtetit!

Si shoqatë profesionale gjithmonë kemi punuar në drejtim të përgatitjes së anëtarëve tanë të jenë të gatshëm t'i përgjigjen të gjitha turbulencave të cilat janë duke ndodhur në ekonomi si dhe ndërrimeve të reja dhe implikimeve që ata janë duke kaluar në profesion, por gjithashtu Shoqata nuk ka rreshtur së punuari në drejtim të inkorporimit të ideve dhe aktiviteteve të reja e të cilat janë të shpjeguara në këtë raport.

ShKÇAK besoj është vetmja organizatë e cila është pozicionuar të mos ketë asnjë involvim për interes komercial apo politik, ajo ku ShKÇAK e ka fokusin e saj është të iu ofrojë të gjitha palëve me interes një bashkëpunim si në sektorin privat po ashtu edhe në atë publik, përmes dialogut dhe debateve duke u munduar të ngris vetëdijen e tyre për rëndësinë e profesionit.

Kontributi i vazhdueshëm i Shoqatës është dhënë në përmirësimin e raportimit financiar si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, duke promovuar zhvillimet e reja për adoptim dhe implementim të standardeve ndërkombëtare.

ShKÇAK në emër të profesionit ka vazhduar të jetë zëri i vetëm për vetëdijësimin e të gjitha institucioneve shtetërore si dhe organizatave të tjera në promovimin e interesit publik e cila është esenciale për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm.



■ Nga e majta: Arbër Hoti, Lulzim Zeka, Nora Jusufi, Teuta Karameta, Burim Ahmeti, Edona Perjuci-Uka, Lendita Shahini, Torvioll Ukëhaxhaj, Ermal Kozgori, Ardiana Bunjaku, Burbuqe Gjonbalaj, Art Navakazi

Aktivitetet dhe puna e ShKÇAK gjatë vitit 2015

Viti 2015 për ShKÇAK shquhet si vit i avancimit të programeve kualifikuese në sektorë të rinj, vit i rritjes së bashkëpunimit me organizatat profesionale të kontabilitetit si dhe i dhënies së kontributit në politikbërje e ligjvënies në të mirë të zhvillimit të sektorit financiar në vendin tonë.

SievetmjaorganizatënëKosovëqëështëanëtareeplotë e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK/ IFAC) dhe në përputhje me kërkesat e Deklaratave të Obligimeve të Anëtarësisë (DOA), ShKÇAK vazhdon të zbatojë standardet ndërkombëtare në zhvillimin e mëtutjeshëm të profesionit të kontabilitetit dhe auditimit si dhe me kualifikimin dhe zhvillimin afatgjatë të anëtarëve të saj.

Për të theksuar disa nga ngjarjet kryesore të ShKÇAK-së për vitin 2015, raporti në vazhdim paraqet një pasqyrë të përgjithshme të punës dhe aktiviteteve të saj duke u fokusuar në arritjet kryesore të parapara me planin e punës të këtij viti.

Me aprovimin e Strategjisë katër-vjeçare në Asamblenë e Përgjithshme në vitin paraprak, Shoqata ka vazhduar aktivitetet e veta për të përmbushur objektivat e kësaj strategjie si dhe misionin, vizionin dhe qëllimin e vet.



■ Pamje nga Mbledhja e Përgjithshme e Asamblesë

Një ndër angazhimet më të rëndësishme dhe frytdhënëse për vitin 2015 ka qenë fokusi dhe puna e palodhshme drejt zhvillimit të kurrikulumeve dhe bashkëpunimeve për ofrimin e specializimeve të reja brenda programit certifikues.

Përveç investimit të energjisë dhe resurseve të saja në zhvillimin e këtyre dy fushave të rëndësishme, Shoqata gjithashtu i ka dhënë rëndësi të veçantë ngritjes së cilësisë së punës të anëtarëve të saj përmes krijimit

të Departamentit të Sigurimit të Cilësisë i cili ofron mbështetje profesionale për të ngritur besueshmërinë në raporte financiare dhe ato të auditimit.

ShKÇAK do të vazhdojë të rrisë dhe zgjerojë bashkëpunimet me shoqata të tjera profesionale të fushës së kontabilitetit dhe auditimit si dhe me institucione të arsimit të lartë në mënyrë që të gjithë së bashku të kenë kurrikulume të përafërta sipas kërkesave ndërkombëtare.

Rritja e Besueshmërisë përmes Sigurimit të Cilësisë

Në mënyrë që të ofrojë mbështetje profesionale të vazhdueshme për anëtarët e vet, ShKÇAK ka krijuar Departamentin për Sigurimin e Cilësisë me qëllim të intensifikimit të aktiviteteve në drejtim të sigurimit të cilësisë së punës së firmave ligjore dhe auditorëve ligjorë në përputhje me DOA1 të FNK-së e cila parasheh sigurimin e cilësisë nga Organizatat Profesionale të Kontabilitetit (OPK), anëtare të Federatës.

Interesi ynë është ngritja e kualitetit të punës së auditorëve ligjorë dhe firmave të auditimit përmes kontrollit të përvitshëm të cilësisë së punës së tyre.

Prandaj, Departamenti i Sigurimit të Cilësisë në bashkëpunim me përfaqësues të organizatës së ekspertëve PUM të Holandës kanë bërë vizita tek firmat e auditimit dhe kanë vlerësuar raportet e lëshuara nga auditorët në mënyrë që të ofrojnë rekomandime relevante mbi përmirësimin dhe përforsimin e raporteve të cilat auditorët i përgatisin. Përveç kësaj, këto të dhëna shërbejnë edhe si pasqyrë e gjendjes së auditimit në Kosovë e cila do të adresohet përmes aktiviteteve të ndryshme për rritjen e nivelit të auditimit në Kosovë.



■ Pamje nga takimi me auditorët në kuadër të vizitave të Departamentit të Sigurimit të Cilësisë

Në mënyrë që të zgjerohet bashkëpunimi në mes auditorëve dhe të shkëmbehen përvojat, gjatë këtij viti ShkÇAK ka inicuar një projekt të formatit jo-formal për mbështetjen e tyre duke mbajtur takime të përmuajshme të quajtura “Një kafe me auditorët”.

Qëllimi i këtyre takimeve është që të shërbejnë si një forum fizik për auditorët ligjorë ku mund të diskutojnë për brengat, sfidat dhe hapat që duhet ndërmarrë për përmirësimin e profesionit të auditimit dhe tejkalimin e këtyre sfidave.



■ Pamje në një nga takimet në kuadër të “Një kafe me auditorët”

Sigurimi i Cilësisë përmes Digjitalizimit të Punës së Auditorit

Duke ditur rëndësinë e dokumentimit të kryerjes së punës së auditimit në pajtueshmëri me SNA si dhe nevojën për kontroll të cilësisë, anëtarët e ShKÇAK kanë inicuar formimin e një Grupi Punues për përzgjedhjen e një softueri të auditimit i cili i përmbush kushtet dhe nevojat për të bërë një punë sa më cilësore duke u bazuar në standardet ndërkombëtare të auditimit.

Në këtë drejtim, u organizuan një varg takimesh për diskutimin dhe vlerësimin e ofertave për zgjedhjen e softuerit më të përshtatshëm. Pas rekomandimeve të Grupit Punues lidhur me softuerët, auditorët janë anketuar mbi preferencat e tyre për blerjen e softuerit për të cilin pritet të vendoset gjatë vitit 2016.



■ Takim me grupin punues për përzgjedhjen e softuerit adekuat të auditimit

Përdorimi i softuerit të njëjtë nga të gjithë anëtarët e ShKÇAK të cilët kryejnë auditime do të rriste cilësinë e punës së tyre, sepse do t'i ndihmonte auditorët që të ndajnë praktikat më të mira të punës mes vete dhe të menaxhojnë në mënyrë efektive procedurat e auditimit

duke rritur produktivitetin e tërë procesit, përfshirë këtu: vlerësimin e rrezikut, planifikimin, rishikimin dhe përpilimin e raportit të auditorit. Gjithashtu, softueri i auditimit do të mundësonte rishikimin dhe miratimin e detyrave të personelit të auditimit.



■ Takim me përfaqësuesit e IEKA për bashkëpunim rreth përdorimit të softuerit të njëjtë të auditimit

Kualifikimet profesionale të ShKÇAK ekuivalente me kualifikime globale

ShKÇAK ka dëshmuar aftësinë e saj për të qenë në hap me trendet globale sa i përket zhvillimit të profesionit të kontabilitetit dhe auditimit duke ofruar program certifikimi të cilësisë së lartë në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të edukimit (SNE) si dhe kërkesat e Direktivës së 8-të të Ndërmarrjeve mbi Auditimin Ligjor, gjë që i bën programet tona ekuivalente në cilësi me programet e vendeve të zhvilluara të botës.

Duke parë nevojën për certifikime të specializuara në sektorin publik dhe atë për auditim të brendshëm, Shoqata ka marrë parasysh kërkesat e dala nga

bizneset dhe institucionet publike për kualifikimin adekuat të punonjësve të tyre gjatë zhvillimit të plan-programeve të saj, të cilat do të implementohen nga viti 2016.

Prandaj, viti 2015 karakterizohet me vazhdimin e azhurnimit të programit certifikues në sektorin privat, lansimit të programit certifikues në sektorin publik si dhe zhvillimit të skemës së programit certifikues për auditim të brendshëm.



■ Pamje e studentëve të ShKÇAK gjatë trajnimeve



■ Pamje e studentëve të ShKÇAK gjatë provimeve

Azhurnimi i kurrikulumeve garanton cilësi të lartë

Në mënyrë që Shoqata të vazhdojë avancimin e cilësisë së programeve certifikuese dhe materialeve trajnuese, Departamenti Profesional në vazhdimësi monitoron dhe hulumton ndryshimet dhe kërkesat ligjore të vendit, ndryshimet dhe futjen e standardeve

të reja ndërkombëtare të kontabilitetit dhe auditimit si dhe azhurnimin e plan-programeve të OPK-ve në mënyrë që të fitojë akreditim global për të gjitha lëndët që ofron.



■ Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Deloitte Kosova

Si rrjedhojë, gjatë vitit 2015 është punuar në azhurnimin e materialeve të cilat përdoren në të tre nivelet e kualifikimit të ShKÇAK duke bashkëpunuar edhe me akterë vendorë. Në këtë drejtim, vlen të theksohet bashkëpunimi me Deloitte Kosova për azhurnimin e materialit “Ligjet dhe Tatimet në Kosovë”, bashkëpunim i cili tregon devotshmërinë e anëtarëve të saj për të qenë pjesë e zhvillimeve të Shoqatës.

Gjithashtu gjatë këtij viti, është ndryshuar lënda P8 nga “Zbatime të Kontabilitetit Menaxherial” në “Menaxhimi i Performancës”, material i cili është zhvilluar në përputhje me kërkesat e reja të SNE-ve dhe do të hyjë në përdorim nga viti 2016.



■ Lansimi i librit të ri P4 "Ligjet dhe Tatimet në Kosovë" tek studentët e Shoqatës

Specializimi adekuat dhe cilësor i zyrtarëve të Sektorit Publik garanton Transparencë dhe Llogaridhënie

Si rezultat i një bashkëpunimi të suksesshëm në mes të SHKÇAK dhe Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (ZAP), të gjithë zyrtarët e këtij institucioni kanë ndjekur dhe përfunduar çertifikimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI).

Në thelb të këtij bashkëpunimi ishte përgatitja e zyrtarëve të këtij institucioni me aftësi adekuate të menaxhimit të financave publike, raportimit financiar, dhe auditimit të cilat shërbyen si mjete për të ushtruar profesionin në nivel të lartë dhe për të siguruar që opinionet të cilat i lëshojnë do të garantojnë transparencë dhe llogaridhënie për institucionet publike.

Rëndësia e këtij programi specifik është vlerësuar lartë edhe nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (BSNKSP) i FNK-së, prandaj, ky çertifikim u bë lajm global në mënyrë që

edhe OPK-të tjera anëtare të Federatës ta përdorin si model për krijimin e një programi të tillë në shtetet e tyre.

SHKÇAK në vazhdimësi ka punuar ngushtë me qeverinë e Kosovës për ngritjen e kapaciteteve profesionale në sektorin publik. Në këtë drejtim, ka thelluar bashkëpunimin me Institutin e Licencuar për Financa Publike dhe Kontabilitet në Angli (CIPFA) për të zhvilluar një marrëveshje e cila do t'u ofronte anëtarëve të saj perspektivë globale. Në nëntor të këtij viti u nënshkrua marrëveshja në mes të SHKÇAK dhe CIPFA me anë të së cilës, anëtarët e Shoqatës do të kenë mundësi të përfitojnë anëtarësi të dyfishtë. Nëpërmjet këtij programi, anëtarët e shoqatës do të fitojnë një çertifikim të njohur globalisht i cili do t'u mundësojë atyre që njohuritë e arritura përmes këtij çertifikimi t'i vënë në aplikim jo vetëm në Kosovë, por edhe jashtë saj.



■ Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit me CIPFA

Ky program ka për qëllim specializimin e të gjithë zyrtarëve financiarë të institucioneve publike si dhe gjeneratave të reja të studentëve që dëshirojnë të profilizohen në këtë sektor. Çertifikimi në këtë program do të sjellë mundësi më të mëdha punësimi meqenëse është vërtetuar se specializimi në fusha të veçanta i bën profesionistët më të dalluar.

Anëtarët e këtij programi do të jenë pjesë e zhvillimeve vendore dhe ndërkombëtare duke iu mundësuar qasjen në ngjarjet më të reja të profesionit, ndryshimet dhe avancimet në standardet ndërkombëtare të menaxhimit të financave publike.



■ Përfaqësuesit e ShKÇAK dhe CIPFA gjatë ceremonisë së nënshkrimit të marrëveshjes së përbashkët

Kuadrot e kualifikuara dhe të pajisura me çertifikata dhe trajnime përkatëse sipas normave më të larta ndërkombëtare janë parakusht për një qeverisje të mirë korporative të domosdoshme për t'u mishëruar në institucionet publike në Kosovë. Qeverisja korporative dhe transparenca e tillë janë standard primar për

integritet në Bashkimin Evropian. Kosova do të jetë një ndër vendet e para të Evropës Jug-Lindore që ofron një çertifikim të tillë i cili do të kontribuojë në rritjen e transparencës dhe në përmirësimin e qeverisjes korporative në sektorin publik.

Zgjerimi i kualifikimeve të ShKÇAK-së – Auditimi i Brendshëm

Një ndër objektivat e Strategjisë së Shoqatës për vitet 2015-2019 është krijimi i programit të Çertifikimit të Auditorëve të Brendshëm. Kërkesa e lartë për një kualifikim të tillë i cili ende nuk është zhvilluar në Kosovë ka shtyrë Shoqatën të investojë në këtë drejtim. Në mungesë të ekspertizës në Kosovë për të krijuar kurrikulumin dhe materialet për auditim të brendshëm, ShKÇAK gjatë këtij viti ka hulumtuar për mundësitë më të mira për zhvillimin e një programi të tillë ndërkombëtar.

Mosnjohja e Kosovës nga Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) shkakton probleme edhe në bashkëpunime në anën profesionale, mirëpo, ShKÇAK falë reputacionit të mirë që e ka globalisht ka arritur të fillojë bashkëpunimin me Institutin e Auditorëve të Brendshëm (IIA) me bazë në Amerikë, për të krijuar një çertifikim në këtë lëmi i cili është i bazuar në të gjitha materialet dhe programin e ekzaminimit të këtij institucioni. Ky është hapi i parë drejt bashkëpunimit me IIA për implementimin e çertifikimit për Auditorë të Brendshëm.

ShKÇAK do të lansojë këtë program gjatë vitit 2016 për të certifikuar specializimin e individëve në auditim të brendshëm. Kualifikimi për Auditim të Brendshëm do të sjellë një grup profesionistësh të pajisur me aftësitë adekuate të mbikëqyrjes së brendshme të cilët do të kenë ekspertizën e nevojshme në mënyrë që të sigurohet sistemet të duhura të kontrollit në secilin entitet të sektorit publik dhe atij privat. Kjo jo vetëm që iu ndihmon atyre për të pasur një karrierë të suksesshme, por garanton edhe zhvillimin e bizneseve dhe organizatave përkatëse.

Siç edhe u cek më lartë për shkak të kërkesave të shumta për trajnim të auditorëve të brendshëm, SHKÇAK në bashkëpunim me Asociacionin e Institucioneve Mikrofinanciare në Kosovë (AMIK) gjatë vitit 2015 organizuan trajnim për auditorët e brendshëm të institucioneve mikrofinanciare. Trajnimi u organizua me qëllim që të pajisen me njohuri auditorët e brendshëm në lidhje me standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, dallimin në mes të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, kodin e etikës, përgjegjësitë, fazat e auditimit, të cilat u përcollën edhe me udhëzime praktike se si të veprohet gjatë secilës fazë të auditimit të brendshëm.



■ Pamje nga trajnimi i auditorëve të brendshëm të institucionit AMIK

Edukimi i vazhdueshëm profesional (EVP) i domosdoshëm për të qenë në hap me trendet e zhvillimit të profesionit

Përfundimi i trajnimeve kualifikuese në kuadër të të gjitha programeve të secilit sektor nuk shënon fundin e edukimit, në të vërtetë, përfundimi i trajnimeve shënon pajisjen e një personi me njohuri dhe ekspertizë përkatëse për të kryer punë me cilësi të lartë qoftë si teknik, kontabilist, apo edhe auditor. Duke pasparasysh që bordet përkatëse ndërkombëtare dhe vendore publikojnë standarde të reja dhe azhurnojnë ato për të përmirësuar dhe për të siguruar transparencë financiare e cila ndihmon në zhvillimin e bizneseve dhe ekonomive të të gjitha vendeve, edukimi i vazhdueshëm profesional është e vetmja rrugë për të qenë në hap me trendet globale.

Kontabilistët dhe Auditorët e Çertifikuar duhet të ofrojnë shërbime efektive dhe të cilësisë së lartë që të përfitojnë dhe mbajnë punët e tyre dhe besimin e klientëve të tyre. Ata kanë obligim etik tek klientët, punëdhënësit, dhe akterët e tjerë të kryejnë punën e tyre me kujdes. Mbajtja e kompetencave profesionale u lejon profesionistëve të vazhdojnë të mësojnë gjatë karrierës, të zhvillojnë aftësitë e tyre teknike dhe të jenë në hap me ndryshimet dhe risitë në fushën e kontabilitetit dhe auditimit.



■ Pamje nga EVP-të e organizuara në bashkëpunim me ATK-në

Prandaj, ShKÇAK kërkon që të gjithë anëtarët të përbushin kërkesat e EVP-së, në mënyrë që të ruajnë kompetencat e tyre profesionale dhe personale. Kjo është detyrë ndaj vetes, ndaj klientëve dhe punëdhënësve të tyre, si dhe ndaj vetë ShKÇAK. Në mënyrë që anëtarët e saj të përforcojnë njohuritë e tyre dhe të njoftohen me risitë në legjislacionin e standarde, gjatë vitit 2015 ShKÇAK ka organizuar një gamë të gjerë të EVP-ve me tema të cilat anëtarët i kanë konsideruar si relevante dhe me interes për profesionin e tyre.

ShKÇAK bashkëpunoi me Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) gjatë këtij viti për të organizuar EVP mbi ndryshimet dhe zbatimin e Pakos së re Fiskale. Përpos ndryshimeve në legjislacionin vendor, u organizuan edhe EVP relevante mbi përforcimin dhe azhurnimin e njohurive të kontabilistëve dhe auditorëve të çertifikuar në zbatimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) dhe Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, përfshirë këtu SNA 240, SNA 250, SNA 260, SNK 27 dhe SNK 8.



■ Pamje nga EVP-të e organizuara rreth SNA-ve dhe SNK-ve

Në kuadër të sigurimit të cilësisë, ShKÇAK vazhdoi me organizimin e EVP-ve, në bashkëpunim me organizatën PUM e financuar nga qeveria e Holandës. "Trajnimi Praktik për Auditim" u fokusua në të gjeturat nga vizitat e bëra tek auditorët ligjorë dhe kishte për qëllim që t'i pajisë ata me njohuri rreth implementimit praktik të SNA-ve, përfshirë, procedurat lidhur me

pranimin e klientëve, materialitetin e përgjithshëm dhe të performancës, rreziqet e biznesit dhe mashtrikeve, kontrollet e brendshme, analizën e rreziqeve dhe qasjen e auditimit, komunikimin e mangësive në kontrollet e brendshme, përfundimin e fazës së vlerësimit, përfundimin e auditimit dhe lëshimin e opinionit të auditimit.

SHKÇAK dhe Fondacioni SNRF organizuan EVP-në Rajonale «SNRF për NVM-të»

Gjatë vitit 2015 me hyrjen në fuqi të udhëzimit administrativ nr 02/2014 "Zbatimi i SNRF-së për Shoqëritë Tregtare të mesme dhe të vogla" për implementimin e standardeve ndërkombëtare të

raportimit financiar për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), ShKÇAK organizoi seminar regjional në bashkëpunim me Fondacionin SNRF, organizim i parë i këtij lloji për vendet e Evropës Juglindore.



■ Pamje nga EVP "SNRF për NVM-të – Ndryshimet dhe Ngjashmëritë"

Ky seminar ka arritur të tërheq vëmendjen e rreth 200 profesionistëve vendorë, standardvënësve ndërkombëtarë, dhe përfaqësuesëve nga Ministria e Financave, Banka Botërore, USAID, Universiteteve, dhe Shoqatave Profesionale të rajonit. Seminari kishte për qëllim t'i pajisë pjesëmarrësit me njohuritë lidhur me ndryshimet dhe ngjashmëritë ndërmjet SNRF-ve të plota dhe SNRF-së për NVM-të.

Raportimi përmes SNRF-ve në Kosovë do të ndikojë në transparencë dhe besueshmëri më të madhe në pasqyra financiare të bizneseve të vogla dhe të mesme.

ShKÇAK vazhdon të bashkëpunojë me organizata ndërkombëtare duke iu përgjigjur nevojave të tregut të Kosovës si dhe rajonit në fushën e kontabilitetit dhe auditimit si dhe fushat që lidhen drejtpërdrejt me këto.

Shërbimi për anëtarë prioritet për ShKÇAK

Fokusi i SHKÇAK-së është të jetë sa më afër anëtarëve të saj që ata të jenë të informuar me kohë për zhvillimet e reja vendore dhe ato ndërkombëtare në profesionin e kontabilitetit dhe auditimit, si azhurnime të direktivave, kërkesat ligjore, dhe publikimet e azhurnimet e standardeve të lëshuara nga standardvënësit ndërkombëtarë dhe vendorë.

Në mënyrë që plasimi i informatave të bëhet sa më i shpejtë, mjetet e informimit janë azhurnuar gjithë që ka rezultuar në hapjet e llogarive në Facebook, Instagram, dhe Twitter. Bashkëveprimi në këto rrjete sociale me anëtarët po ofron një alternativë të pranimit të informatave nga Shoqata dhe shpeshherë rezulton më e shpejtë. Në këtë mënyrë Shoqatës i mundësohet që në çdo moment t'u përgjigjet kërkesave dhe nevojave të anëtarëve të vet.



■ Pamje nga Mbledhja Vjetore 2015

ShKÇAK ka punuar intenzivisht në gjetjen e modaliteteve se si mund të jetë edhe më afër anëtarëve të saj dhe në uebfaqen e Shoqatës planifikohet që gjatë vitit 2016 të ketë edhe forume ku anëtarët do të mund të komunikojnë në mes vete drejtpërdrejt lidhur me çështjet që ndërlidhen me profesionin. Gjithashtu, ShKÇAK ka zhvilluar pyetësorë të ndryshëm me qëllim që anëtarët e saj të shprehin kërkesat që do t'iu ndihmonin atyre për zhvillim profesional.

Shoqata inkurajon anëtarët që të ofrojnë inputin e tyre në të gjitha zhvillimet si brenda Shoqatës po ashtu edhe në legjislacione vendore dhe standarde ndërkombëtare.

ShKÇAK do të vazhdojë të jetë e përkushtuar në përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit sa më të mirë të komunikimit në mes të anëtarëve dhe Shoqatës për plotësimin e nevojave dhe kërkesave të tyre si dhe ofrimin e shërbimeve sa më cilësore.

Shpallja e studentëve të dalluar nxit ngritjen e nivelit të performancës

Garantimi i cilësisë së performancës të studentëve dhe anëtarëve të saj gjithnjë ka qenë në fokus të Shoqatës gjë që e ka bërë Shoqatën lidere të cilësisë në treg. ShKÇAK çdo vit mundohet të marrë iniciativa të reja e një ndër to gjatë këtij viti ishte edhe shpallja e studentit të dalluar në secilin nivel. ShKÇAK e ka konsideruar si të domosdoshme vlerësimin dhe inkurajimin e anëtarëve të rinj të cilët sapo kanë filluar rrugëtimin drejt certifikimit dhe specializimit të tyre në këto fusha

për t'i shtyrë ata të mësojnë dhe të punojnë sa më shumë që të arrijnë rezultate të larta të cilat më vonë do të kthehen në karrierë të suksesshme.

Si rrjedhojë, gjatë ceremonisë së fundvitit u shpallën tre studentët e dalluar të secilit nivel. Studentët e zgjedhur përfituan mirënjohje dhe anëtarësi falas për vitin 2016.



Lirim Kryeziu

*Student i dalluar
i nivelit "Auditor i
Çertifikuar"*



Ermira Desku

*Studente e dalluar
e nivelit "Teknik i
Kontabilitetit"*



Yll Fondaj

*Student i dalluar i
nivelit "Kontabilist i
Çertifikuar"*

Në po këtë ceremoni u shpallën të gjithë të certifikuarit e vitit 2015 që gjithsej ishin 109 anëtarë. Prej tyre, 15 anëtarë kanë fituar thirrjen "Auditor i Çertifikuar", 14 anëtarë kanë fituar thirrjen "Kontabilist i Çertifikuar" dhe 80 anëtarë kanë fituar thirrjen "Teknik i Kontabilitetit".

Përfaqësimi i ShKÇAK në nivel Vendor, Rajonal, dhe Ndërkombëtar

Duke qenë shembull global dhe organizatë me ndikim dhe reputacion në vend dhe jashtë vendit, Shoqata vazhdoi që edhe gjatë këtij viti të ishte pjesë

aktive e grupeve punuese, takimeve, mbledhjeve, diskutimeve dhe konferencave në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.



■ Përfaqësimi i ShKÇAK në grupe punuese

Qëllimi i angazhimit të Shoqatës në komisione dhe projekte të ministrive, organizatave ndërkombëtare në Kosovë, odave ekonomike dhe organizatave joqeveritare, është për ngritjen e cilësisë së raportimit financiar dhe auditimit, mbrojtjen e interesit publik dhe zhvillimin e profesionit në Kosovë. Shoqata përmes anëtarësimit në Komisionin për Zhvillimin e Organizatave Profesionale të Kontabilitetit/Auditimit (PAODC) të FNK-së, bënë që Kosova si një shtet i ri të ketë ndikim në vendimmarrjen globale.

Një ndër ngjarjet që vlen të theksohet ishte edhe pjesëmarrja e ShKÇAK në Kongresin Afrikan të Kontabilitetit dhe Auditimit (ACOA 2015) i cili u mbajt

në Pailles, Mauritius, Afrikë me temën: “Ngritja e Afrikës: Bashkëpunimi për Rezultate”. Gjatë kongresit, Drejtoresha Ekzekutive në rolin e anëtares së Komisionit për Zhvillimin e Organizatave Profesionale të Kontabilitetit dhe Auditimit (PAODC) të FNK-së, ishte edhe prezantuese në panelin me temë: “Fuqizimi i kontabilitetit dhe auditimit, avancimi i bashkëpunimit” me ç’rast prezantoi të arriturat e ShKÇAK-së në zhvillimin e kapaciteteve profesionale si dhe sfidat për zhvillimin dhe zgjerimin e mëtejshëm të profesionit në Kosovë, duke ndarë me pjesëmarrësit përvojat për zhvillimin e shoqatave profesionale në vendet në zhvillim.



■ Përfaqësimi i ShKÇAK në grupe punuese

Gjithashtu, ShKÇAK si organizatë anëtare në Federatën Mesdhetare të Ekspertëve të Kontabilitetit (FCM) mori pjesë në takimin e Asamblesë së Përgjithshme të FCM-së në muajin Tetor 2015, ku u zgjodh Bordi Ekzekutiv i Federatës për mandatin 2016 dhe 2017. Drejtoresha Ekzekutive e ShKÇAK u zgjodh anëtare në këtë bord.

Përfaqësuesit e ShKÇAK gjithashtu u nominuan që të jenë pjesë e Komisionit Teknik të FCM-së për zhvillimin e strategjisë të kësaj federate.

ShKÇAK pjesëmarrëse aktive në Komunitetet e Praktikës për Edukim dhe Raportim Financiar të organizuar nga QRRF në kuadër të programit EU-REPARIS të Bankës Botërore

Objekti i programit Rruga drejt Evropës: Programi i Reformës në Kontabilitet dhe Forcimit Institucional (EU-REPARIS) është të mbështesë zbatimin e kornizës së raportimit financiar të korporatave në përputhje me acquis communautaire të BE-së në gjashtë vendet

e Evropës Juglindore me qëllim të promovimit të transparencës dhe besueshmërisë së informacionit financiar.



■ Pamje nga Komuniteti i Praktikës për Edukim në Kontabilitet dhe Auditim (EduCoP) i organizuar në Shkup

ShKÇAK edhe gjatë vitit 2015 ka qenë pjesëmarrëse e një sërë trajnimesh të organizuara nga Qendra për Reformimin e Raportimit Financiar (QRRF) pranë Bankës Botërore. Në fakt, përfaqësues të ShKÇAK kanë marrë pjesë në një sërë seminaresh të kësaj qendre përmes Komunitetit të Praktikës për Edukim në Kontabilitet dhe Auditim (EduCoP), Komunitetit të Praktikës për Raportim Financiar (FRCoP) si dhe Trajnimeve të Trajnerëve.

Gjatë vitit 2015 Banka botërore ka vendosur që takimet në kuadër të komunitetit të praktikave për edukim, të mbahen në vendet e anëtarëve pjesëmarrës të EU-REPARIS. Punëtoritë e para me temën “Arritja e Shkëlqyeshmërisë në Edukim: Përafrimi i kurrikulumeve të universiteteve për kontabilitet dhe auditim sipas standardeve ndërkombëtare” janë mbajtur në Shkup dhe Prishtinë. Gjatë këtyre punëtorive janë shtjelluar

tema ku fokusi kryesor i së cilave ishte roli që kanë universitetet në edukimin e studentëve të kontabilitetit dhe auditimit. Në këtë kontekst, QRRF-ja ka zhvilluar një pilot studim në shtete të EU REPARIS: Bosnje dhe Hercegovinë, Maqedoni, Serbi, Shqipëri, Kosovë dhe Mal të Zi për të adresuar përafrimin me kërkesat ndërkombëtare të edukimit.

Në punëtorinë e QRRF të mbajtur në Prishtinë u prezantuan rezultatet e studimit krahasimor me Universitetin e Prishtinës sa i përket kurrikulumit për kontabilitet dhe auditim duke krahasuar përmbajtjen e programeve të universitetit me programe të tjera të edukimit profesional. Gjithashtu në këtë punëtori, përfaqësuesit e ShKÇAK prezantuan rreth sistemit profesional të edukimit të krijuar nga ShKÇAK dhe sferat e reja të krijimit të programeve çertifikuese nga ana e shoqatës.



■ Pamje nga Komuniteti i Praktikës për Edukim në Kontabilitet dhe Auditim (EduCoP) i organizuar në Prishtinë

Me këto studime është arritur në përfundim se kurrikulumet e universiteteve kanë nevojë për azhurnim në mënyrë që studentët e drejtimit të kontabilitetit dhe auditimit të fitojnë njohuritë e nevojshme dhe të përgatiten për profesion. Një studim i tillë do të realizohet edhe për organizatat profesionale gjatë vitit 2016.

Ndërkaq, seminari në kuadër të Komunitetit të Praktikës për Raportim Financiar (FRCoP) i organizuar në Tiranë, ofroi një forum për pjesëmarrësit për t'u rilidhur dhe për të qenë të informuar për ndryshimet e fundit në *acquis communautaire* të BE-së, përkatësisht

në Direktivën e re për Kontabilitet dhe Auditim, për të vlerësuar reformat e kontabilitetit dhe auditimit në vendet pjesëmarrëse dhe për të diskutuar sfidat dhe zgjidhjet e propozuara për ndryshimin e ligjeve të tyre sipas kërkesave të reja të Direktivave të BE-së.

Ligjëruesit e ShKÇAK po ashtu vazhdojnë të jenë pjesëmarrës në "Trajnimin e Trajnerëve" në kuadër të punësive të QRRF-së. Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte zhvillimi i kapaciteteve të profesionit të auditimit dhe zhvillimin profesional të trajnerëve bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA).



■ Përfaqësimi i ShKÇAK në grupe punuese

Trajnimet u fokusuan posaçërisht në adresimin e nevojave dhe sfidave të firmave të vogla dhe të mesme të auditimit në implementimin e SNA-ve dhe për mënyrat se si duhet udhëzuar auditorët të zhvillojnë sigurimin e cilësisë në firmat e tyre. Gjatë punëtorive,

Arbër Hoti, Udhëheqës i Departamentit për Kontroll të Cilësisë prezatoi udhëzuesin e thjeshtëzuar për kërkesat minimale të dokumenteve për kontroll të cilësisë të firmave të auditimit, i cili është përgatitur nga Shoqata.

Bashkëpunimet rajonale

Në vazhdim të aktiviteteve për zgjerimin e bashkëpunimit rajonal ShKÇAK gjatë vitit 2015 është punuar në finalizimin e draft marrëveshjes së bashkëpunimit me Institutin e Auditorëve të Autorizuar të Maqedonisë (IORRM). Përmes kësaj marrëveshje, ShKÇAK dhe IORRM do të hapin dyert e bashkëpunimit në disa fusha

të përbashkëta interesi, aktivitetet e të cilave do të jenë në pajtueshmëri me DOA-të e FNK-së dhe Standardet Ndërkombëtare. Nënshkrimi i kësaj marrëveshje do të ketë rëndësi të madhe në promovimin e vlerave dhe përvojave të Shoqatës në rajon.



■ Pamje nga takimi me Këshillin e Lartë të Shtetit

Bashkëpunimi me Kontrollin e Lartë të Shtetit në Shqipëri vazhdoi edhe gjatë vitit 2015 ku është punuar lidhur me draftimin e skemës së çertifikimit të zyrtarëve të këtij institucioni. SHKÇAK në këtë

drejtim ka kontaktuar edhe me IEKA që të jetë pjesë e implementimit të këtij çertifikimit në Shqipëri dhe të ndihmojë në zhvillimin e materialeve për legjislacionin në Shqipëri.

Mbrojtja e interesave të anëtarëve përmes avancimit të profesionit të kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë

ShKÇAK jo vetëm që punon në mbështetjen dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të anëtarëve të vet, por po ashtu kontribuon në draftimin e ligjeve, politikave dhe marrjes së vendimeve për iniciimin e projekteve çdoherë kur është e nevojshme.

Si anëtare e FNK-së, ShKÇAK është e obliguar që të bëjë përpjekjet më të mira për zhvillimin e profesionit të kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë. Duke parë që Ligji nr. 04/L014 për Kontabilitet, Raportim Financiar, dhe Auditim ka zbrastësira dhe nuk i plotëson kushtet të cilat i dikton klima e biznesit në Kosovë, ShKÇAK ka formuar grupin punues për harmonizimin e këtij ligji me kërkesat e BE-së dhe standardvënësve ndërkombëtar.

Edhe Zyra e BE-së në Kosovë, sektori për integritet evropian dhe sektori për bashkëpunim, ka ftuar në takim përfaqësuesit e ShKÇAK për të vlerësuar implementimin e kërkesave të cilat dalin nga BE-ja në sferën e kontabilitetit, auditimit dhe raportimit financiar. Gjatë takimit ShKÇAK theksoi se Kosova ka Ligjin për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim i cili përmban kërkesat që dalin nga Direktiva, por që implementimi i ligjit lë shumë për të dëshiruar, fakt që e vërtetojnë edhe dokumentet që Shoqata i prezantoi në takim, sikurse: Raporti i Mbikëqyrjes së Standardeve dhe Kodeve në Kontabilitet dhe Auditim (ROSC) i Bankës Botërore si dhe dokumenti i përmbledhur i seminarit të organizuar nga ShKÇAK lidhur me implementimin e të gjeturave të raportit ROSC.

ShKÇAK vazhdon të jetë pjesë e Grupit Punues të MTI-së për Liberalizim të Shërbimeve Profesionale në mes Shteteve të CEFTA-s dhe Draftimin e Ligjit të Ri të Falimentimeve

Duke ditur rolin e madh të negociatave mbi shërbimet profesionale në nivel të shteteve anëtare të CEFTA-së, kontributi i Shoqatave Profesionale dhe koordinimi adekuat përbën element shumë të rëndësishëm për interesat e vendit tonë në këtë sferë. Prandaj, Shoqata ka vazhduar të ofrojë kontributin e vet në grupin punues të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI) për Liberalizimin e Shërbimeve Profesionale në mes shteteve të CEFTA-s.

Një ndër pikat kryesore dhe më sfiduese të strategjisë së zhvillimit ekonomik në Kosovë mbetet hapja e tregjeve dhe mundësia për shkëmbim të lirë të shërbimeve dhe mallrave, brenda dhe jashtë vendit. Prandaj, ShKÇAK angazhohet në mënyrë që kuadrot profesionale të kontabilitetit dhe auditimit të jenë të kualifikuara për punë dhe të jenë në gjendje të ofrojnë shërbimet e tyre kudo. Gjatë këtyre takimeve, ShKÇAK theksoi se lidhur me profesionin e kontabilitetit dhe



■ Takim me Ministren e MTI-së – Hykmete Bajrami

auditimit, Kosova nuk ka barrierë ndaj shteteve tjera dhe ka këshilluar grupin negociator të kërkojë reciprocitet me vendet e tjera.

ShKÇAK vazhdon të jetë pjesë e Grupit Punues të MTI-së për draftimin e Ligjit të ri për Falimentim, Likuidim dhe

Riorganizim. Kontributi i ShKÇAK në të gjitha takimet e këtij grupi punues ishte konstruktiv, veçanërisht duke pasur parasysh faktin se Shoqata ka zhvilluar programin e çertifikimit në fushën e Insolencës.

ShKÇAK - Pjesë e zyrës së Komunitetit të Biznesit pranë Kuvendit të Kosovës

Me qëllim të ofrimit të qasjes së drejtpërdrejtë të bizneseve dhe shoqatave në hartimin dhe amandamentimin e ligjeve, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës ka krijuar Zyrën e Komunitetit të Biznesit.

ShKÇAK, duke pasur rol tejet të veçantë në zhvillimin ekonomik të vendit, iu bashkua kësaj zyre në mesin e Odës Ekonomike Amerikane, Aleancës Kosovare të Bizneseve, Odës Ekonomike Gjermane në Kosovë, Odës Tregtare Kosovare-Turke, Këshillit Evropian për

Investime, Shoqatës së Bankave të Kosovës.

Në këtë kontekst, në tryezën e rrumbullakët të organizuar nga kjo zyrë me titull "Rekomandimet e komunitetit të biznesit për politikën fiskale" ShKÇAK prezantoi rekomandimet për amandamentimin e ligjit për TVSH, TAP dhe TAK. Po ashtu në të ardhmen Shoqata do të vazhdojë të iniciojë dhe kontribuojë rreth ligjeve dhe udhëzimeve administrative të cilat kanë të bëjnë me profesionin.



■ Takim me Kryetarin e Kuvendit të Kosovës – Kadri Veseli

Bashkëpunimi i ShKÇAK me palët e tjera të interesit

Bashkëpunimi i Shoqatës me palët e interesit në Kosovë, Odën Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK) dhe organizata e institucione të tjera, ka vazhduar edhe gjatë vitit 2015. Ky bashkëpunim është thelluar duke u bazuar në interesat e përbashkëta por edhe në interesin e përgjithshëm me qëllim të krijimit të një infrastrukture ligjore në vend që do të siguronte zhvillimin e bizneseve që operojnë në Kosovë, qofshin ato vendore apo të huaja.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, SHKÇAK ka qenë mjaft aktive në ofrimin e komenteve dhe propozimeve gjatë draftimit të pakos së re fiskale respektivisht të Ligjit për TAK, TAP dhe TVSH, duke e konsideruar se këto ligje janë faktorë tejet të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të Kosovës.



■ Pamje nga grupet punuese në bashkëpunim me OEAK/AmCham

Kontributin e saj aktiv ShKÇAK e ka shprehur edhe përmes pjesëmarrjes në takime dhe tryeza të rrumbullakëta të organizuara nga OEAK për çështje të ndryshme të cilat janë me interes për anëtarësinë e Shoqatës por edhe më gjerë, si: takimi për praktikatat e prokurimit në Kosovë, takimi lidhur me Ligjin për sigurime shëndetësore, takimi lidhur me punësimin joformal dhe sigurinë në punë, ndër të tjera.

ShKÇAK gjithashtu gjatë vitit 2015 ka marrë pjesë edhe në konferenca në të cilat janë diskutuar çështje nga sektori bankar, si konferenca me temën “Ndikimi i Sektorit bankar dinamik në zhvillimin e sektorit privat” dhe konferenca vjetore e Shoqatës së bankave në Kosovë me temën “Financimi i progresit në Kosovë”.



■ Pamje nga takimet me akterë të ndryshëm

Raportet nga komisionet e ShKÇAK

Një nga faktorët që ndikojnë në qeverisjen e mirë të ShKÇAK-së janë komisionet e Shoqatës. Funksion kyç i komisioneve të ShKÇAK-së është angazhimi në plotësimin e objektivave të Shoqatës dhe plotësimit të Deklaratave të Obligimeve të Anëtarësisë të FNK-së.

Aktivitetet e tyre sigurojnë shërbimin në interesin publik, rolin përfaqësues të ShKÇAK-së, rolin e caktimit të standardeve profesionale dhe të edukimit, ruajtjes së integritetit profesional dhe sigurimin e cilësisë së ekspertizës dhe standardeve.

Komisionet e Shoqatës kanë role aktive dhe përveç obligimeve të tyre themelore, angazhohen në inicimin e projekteve dhe aktiviteteve të mëtutjeshme, të cilat e ndihmojnë zhvillimin e mirëfilltë të profesionit në Kosovë.

Raport nga Komisioni për Nominime



Për çdo formë organizative demokratike, prandaj edhe për ShKÇAK, zgjedhjet janë ngjarje me peshë ku anëtarët vendosin kush do të na drejtoj dhe si do të jetë e ardhmja e shoqatës tonë. Zgjedhjet, edhe në kohërat e krizave më të mëdha, kanë qenë moment i kthesës, optimizmit të ri dhe hovit. Jam i bindur se zgjedhjet që na presin mund të jenë të tilla.

Nuk ka vend për tërheqje, arma më e fuqishme e demokracisë edhe më tutje mbetet fletëvotimi – e ai është në duart e juaja. Jam i bindur se në mesin tonë ka moral, etikë dhe vullnet, se kemi fuqi dhe vizion për të kontribuar në ndërtimin e të ardhmes më të mire për shoqatën, anëtarësinë dhe gjeneratat e profesionistëve që po vijnë.

Për këtë, nominoni anëtarët e duhur ejani në mbledhjen vjetore dhe u jepni mbështetjen për sfidat që i presin në të ardhmën. Ndoshta vota e juaj bëhet vendimtare për përcaktimin e rrugës dhe drejtimit të ardhshëm të shoqatës dhe profesionit.

Shaban Muharremi
Kryesues i Komisionit për Nominime



■ Anëtarët e Komisionit për Nominime

Nga e majta: Tomorr Zhaveli, Nazmi Pllana, Fahri Breznica, Shaban Muharremi, Burim Zagragja, Adrian Alo

Raport nga Komisioni për Sjellje dhe Disiplinë



Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (SHKÇAK) ka arritur që për një kohë relativisht të shkurtër ti siguroj vetes një vend të rëndësishëm në infrastrukturën zhvillimore të Kosovës. Kjo e arritur e madhe është realizuar përmes implementimit konsekuent të standardeve më të larta ndërkombëtare me synim të përhershëm për zhvillimin dhe avancimin e profesionit në harmoni me këto standarde.

Anëtarësimi disavjeçare në FNK dhe në institucione tjera ndërkombëtare dhe rajonale të kontabilitetit dhe auditimit ka sjellur edhe obligime dhe përgjegjësi për SHKÇAK. Përveç tjerash, janë DOA të FNK-së që konsiderohen si udhërrëfyese për shoqatat dhe institucionet anëtare të FNK.

SHKÇAK në strukturën e saj i ka mekanizmat për implementimin e këtyre standardeve dhe në kuadër të këtyre mekanizmave e ka edhe Komisionin për Hetim dhe Disiplinë i cili është përgjegjës për implementimin e DOA 6 – “Hetim dhe Disiplinë” si një prej fushave tejet të ndjeshme që vazhdimisht duhet të monitorohet.

Prandaj, Komisioni Disiplinor përmes implementimit të DOA 6, në kontinuitet angazhohet për vetëdijesimin e anëtarëve të Shoqatës sepse, aplikimi i profesionalizmit dhe etikës profesionale në punën e anëtarëve është kyç për mirëmbajtjen e profesionit dhe mbrojtjes së reputacionit të secilit si individ, por edhe të Shoqatës si tërësi.

Përveç kësaj, Komisioni për Hetim dhe Disiplinë do të vazhdojë në promovimin e vazhdueshëm të Kodit të Etikës si bazë mbi të cilën do të mbështetet profesionalizmi i të gjithë anëtarëve të SHKÇAK-së. Respektimi i parimeve themelore të Kodit Etik është obligim i çdo anëtarë përderisa shkelja e këtyre parimeve sjell pasoja të dëmshme jo vetëm për anëtarët por edhe për shoqatën dhe mbi të gjitha për interesin publik për mbrojtjen e të cilit angazhohet SHKÇAK.

Në këtë aspekt, Komisioni do të sigurohet që anëtarët e SHKÇAK janë të azhurnuar dhe vazhdojnë të mbajnë tema për Kodin Etik me qëllim të rifreskimit të njohurive të tyre.

Komisioni u shpreh mirënjohje anëtarëve të Shoqatës për profesionalizmin e tyre që vërtetohet edhe me faktin se gjatë vitit raportues nuk ka pasur asnjë rast në kundërshtim me Kodin Etik apo shkelje të rregullave të përcaktuara me dokumentet tjera themelore të SHKÇAK. Kjo flet mjaftueshëm se janë anëtarët vetë ata të cilët i mbrojnë vlerat profesionale të arritura përkundër sfidave të shumta.

Komisioni për Hetim dhe Disiplinë inkurajon anëtarët, por edhe palët e treta që të paraqesin çdo rast të veprimeve që mund të jenë të dëmshme dhe që mund të cenojnë interesin profesional, por edhe interesin e përgjithshëm.

Në realizimin e kompetencave dhe përgjegjësi të veta, Komisioni do ta mirëmbaj bashkëpunimin me Këshillin dhe komisionet e tjera si dhe do të përqendrohet edhe më tepër në krijimin dhe zhvillimin e një koordinimi dhe bashkëpunimi edhe më efikas me Komisionin Disiplinor të KKRF-së. Kjo me qëllim të bashkërendimit të aktiviteteve dhe shkëmbimit të informatave për rastet eventuale që mund të procedohen nga komisionet disiplinore të të dyja palëve sidomos atëherë kur rastet janë të ndërlidhura.

Ymer Mehmeti
Kryesues i Komisionit për Hetim dhe Disiplinë



■ Anëtarët e Komisionit për Hetim dhe Disiplinë

Nga e majta: Muhamet Feka, Bahri Hyseni, Ymer Mehmeti, Hysen Ramabaja, Agim Bulliqi

Raport nga Komisioni i Sigurimit të Cilësisë



Roli i kontrollit të cilësisë është tejet i rëndësishëm për zhvillimin e profesionit të kontabilitetit dhe auditimit, në të njëjtën kohë është edhe shumë kritik dhe sfidues për t'u implementuar në vendet në tranzicion duke marrë parasysh zhvillimin ekonomik në vend. Roli i bizneseve gjithashtu është kritik për një implementim të drejtë të raportimit financiar, gjë që ndikon shumë në arritjet e qëllimeve tona për një implementim të mirëfilltë të profesionit. Duke mos e ditur rëndësinë e auditimit të pasqyrave financiare ka ndikuar edhe në çmimin e këtij shërbimi gjë që ka vështirësuar zhvillimin e profesionit në nivel më të lartë. Për ne si Shoqatë, e posaçërisht detyrë e këtij komisioni është që të gjejmë mënyrën për të ngritur reputacionin e profesionit si dhe rëndësinë e saj për zhvillim të bizneseve e cila ndikon gjithashtu edhe në zhvillim ekonomik të vendit.

Një hap të rëndësishëm që ju anëtarë të nderuar keni marrë gjatë vitit 2015 ishte lejimi i hapjes së Departamentit të Kontrollit të Cilësisë brenda zyrës ekzekutive të ShKÇAK. Duke e njohur rolin dhe rëndësinë që ka një funksionim efektiv i sistemit të kontrollit të cilësisë në ngritjen e besueshmërisë në pasqyrat financiare të audituara dhe për mbrojtjen e interesit publik, aprovimi i hapjes së këtij departamenti ishte një vendim i duhur i Asamblesë së ShKÇAK.

Qëllimi primar i Komisionit dhe departamentit të KC gjatë vitit 2015 ishte zhvillimi i procedurave për funksionim sa më efikas të departamentit i cili do të ndihmojë në ngritjen e kapaciteteve profesionale tek anëtarët e Shoqatës si dhe implementimin e drejtë të kërkesave ligjore të vendit si dhe ato të FNK-së – DOA 1, gjithnjë duke u bazuar në planin strategjik dhe planin e punës të ShKÇAK.

Në këtë drejtim si prioritet tjetër i këtij komisionit dhe departamentit të KC gjatë vitit 2015 ishte edhe bashkëpunimi i ndërsjellë me komisionin e sigurimit të cilësisë të KKRF-së për të rishikuar mundësitë e bashkëpunimit ndërmjet këtyre dy komisioneve në mënyrë që mbikëqyrja publike e auditorëve dhe firmave të ligjore të auditimit të jetë sa më efikase dhe efektive dhe të prodhojë rezultate konkrete në ngritjen e cilësisë së këtij profesioni.

ShKÇAK në bashkëpunim me KKRF-në, ka organizuar një takim të përbashkët me të gjithë auditorët ligjorë për të diskutuar të gjeturat kryesore të kontrollit të cilësisë dhe për ti shpjeguar të gjitha kërkesat të cilat dalin nga Udhëzimet Administrative të KKRF-së në raport me kontrollin e cilësisë.

Edhe gjatë vitit 2015 departamenti i kontrollit të cilësisë ka vazhduar rishikimin e cilësisë të punës së auditorëve ligjorë dhe firmave ligjore si dhe duke u bazuar në gjetjet e përgjithshme nga raportet e kontrollit të cilësisë ka dizajnuar dhe organizuar EVP intensive për të gjithë auditorët ligjorë. Kjo EVP ka qenë mjaft e përqendruar në eliminimin e mangësive kryesore të cilat janë hasur gjatë rishikimit të dosjeve të auditimit gjatë viteve paraprake dhe besojmë që një aktivitet i tillë do të ketë ndikim në ngritjen e cilësisë së auditimit. Përpos realizimit të vizitave dhe organizimit të EVP-së, ky departament në çdo moment ka qenë në dispozicion të auditorëve për të gjitha pyetjet dhe kërkesat të cilat i kanë rreth zbatimit praktik të kërkesave të standardeve ndërkombëtare të auditimit (SNA-të / ISA-të). Në këtë drejtim është marrë vendim të organizohen takime mujore me auditorët ligjorë në mënyrë që të diskutohen të gjitha çështjet të cilat janë relevante për avancimin e profesionit.

Viti 2016 do të jetë një vit i zhvillimeve më intensive në aspektin e kontrollit të cilësisë, ku do të punohet edhe në idenë e kontrollit të cilësisë të punës së firmave të kontabilitetit, të cilat gjithashtu kanë përgjegjësi publike pasi që ofrojnë shërbime ndaj publikut të gjerë.

Në fund me lejoni të kërkoj nga të gjithë ju të nderuar anëtarë që të jeni sa më aktiv me sugjerimet e juaja ndaj organeve të ShKÇAK në mënyrë që puna e organeve ekzekutive të ShKÇAK të ndikoj ndikojë në ngritjen e cilësisë dhe besueshmërisë së raportimeve financiare në Kosovë.

Ardiana Bunjaku
Kryesuese e Komisionit për Sigurim të Cilësisë



■ Anëtarët e Komisionit për Sigurim të Cilësisë

Nga e majta: Fahri Breznica, Ardiana Bunjaku, Lekë Musa, Naim Avdiu

Raport nga Komisioni për Edukim Profesional



Komisioni për Edukim Profesional pranë Shoqatës është i angazhuar në zhvillimin e mëtutjeshëm të procesit të trajnimeve në kuadër të programit certifikues të Shoqatës. Duke qenë një nga akterët kyç në këto zhvillime, ky Komision ka për detyrë dhe përgjegjësi që të kujdeset në zbatimin e plotë të Standardeve Ndërkombëtare të Edukimit dhe kërkesave që dalin nga Deklaratat e Obligimeve të Anëtarësisë të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve.

Gjatë vitit 2015, Komisioni ka qenë aktivisht i involvuar në përcaktimin e plan programit, kërkesave dhe kushteve krijimin e certifikimit të auditorëve të sektorit publik, ku Komisioni detajisht ka shqyrtuar kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Sektorit Publik dhe të njëjtat i ka inkorporuar në materialet e trajnimit për këtë certifikim, duke i përshtatur ato me kërkesat legjislative në Kosovë.

Në të njëjtin drejtim është punuar edhe në shqyrtimin e modaliteteve për të ofruar certifikim të ri në Auditim të Brendshëm, ku është filluar me hapat e parë drejt bashkëpunimit me Institutin e Auditorëve të Brendshëm me bazë në Amerikë (IIA). Komisioni i Edukimit ka hulumtuar për mënyrat e ndryshme se si këto programe të specializuara të Shoqatës të inkorporohen brenda Shoqatës dhe si të funksionojnë si një tërësi.

Po ashtu gjatë vitit 2015 ka vazhduar bashkëpunimi me Universitetet në Kosovë, ku ndër të tjera është punuar gjatë në përcaktimin e kushteve dhe procedurave për mbikëqyrje të implementimit të programeve për kontabilitet në këto Universitete. E tërë kjo me qëllim për të siguruar se standardet dhe publikimet e bordeve ndërkombëtare në fushën e kontabilitetit, auditimit, menaxhmentit financiar dhe etikës përfaqësojnë një pikë orientimi për profesionin në Kosovë dhe që edukimi profesional dhe shoqata si koncept janë të pranuar të luajnë një rol në zhvillimin e mëtutjeshëm të një kornize gjithëpërfshirëse për edukim dhe trajnim profesional. Komisioni për Edukim ka punuar në azhurnimin dhe publikimin e procedurave për njohje të lëndëve nga Universitetet.

Këtë vit me propozimin e KE Këshilli i Shoqatës ka aprovuar ndryshimin e plan programit të lëndës P8-Zbatime të Kontabilitetit Menaxherial, duke e ndryshuar sipas marrëveshjes me BPP Learning Media, ndryshim ky i cili do t' u mundësojë anëtarëve të Shoqatës që të arrijnë njohje edhe nga një lëndë shtesë e ACCA.

Duke u nisur nga fakti se për të gjithë anëtarët tanë, Shoqata paraqet një urë lidhëse mes trendeve globale profesionale dhe anëtarësisë. Si mjeti më i mirë për të krijuar këtë lidhje është nëpërmjet sesioneve të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional.

Dhe duke pasur parasysh se shoqata në të njëjtën kohë ka synim sigurimin e një llojllojshmërie të këtyre sesioneve në lëmin e raportimit financiar, auditimit, dhe tatimeve, Komisioni për Edukim Profesional është kujdesur që edhe këtë vit të përcaktohet plani i EVP për vitin pasardhës, si dhe të sigurohet implementimi i planit të EVP për vitin 2015. Gjatë përgatitjes së planit të EVP çdo herë ky Komision ka parasysh kërkesat e anëtarësisë të drejtuara në Departamentin e Shërbimit për Anëtarë dhe përmes anketimit online, si dhe nevojave të tregut dhe kërkesave për përmirësimin e mjedisit të raportimit financiar dhe auditimit në Kosovë.

Me reputacionin e lartë që ka arritur Shoqata falë punës së palodhshme të të gjithëve të involvuar në procesin e edukimit dhe trajnimit, vazhdon edhe pas më se dhjetë viteve të punës së saj të jetë lidere në ofrimin e programeve të çertifikimit për kontabilitet dhe auditim. Bazuar në këtë, Ne si Komision jo vetëm që kemi përgjegjësi profesionale por edhe morale që të bëjmë përpjekjet tona maksimale, që në vazhdimësi t' i kushtohet vëmendje dhe rëndësi e veçantë komponentës së edukimit profesional si pjesë për zhvillimin e kapaciteteve në kontabilitet dhe auditim.

Naim Avdiu

Kryesues i Komisionit për Edukim Profesional



■ Anëtarët e Komisionit për Edukim Profesional

Nga e majta: Naim Avdiu, Edona Perjuci-Uka, Arbër Hoti

Raport nga Komisioni për Standarde Profesionale



Komisioni për standarde profesionale monitoron zhvillimet në fushën e raportimit financiar dhe auditimit dhe shërben si pikë referimi dhe diskutimi të çështjeve dhe temave profesionale.

Përkundër përmirësimeve të vazhdueshme ambienti ligjor në fushën e raportimit financiar dhe auditimit mbeten shqetësim i komisionit.

Komisioni ka diskutuar tema të ndryshme në interes të zhvillimit të më tutjeshëm të raportimit financiar dhe auditimit në Kosovë, veçanërisht format e reja të pasqyrave financiare në pajtueshmëri me SNRF-të për NVM-të të publikuara nga Këshilli Kosovar për Raportim Financiar, të cilat janë një hap shumë pozitiv në rritjen e cilësisë së raportimit financiar.

Kompetenca dhe sjellja profesionale janë cilësitë e domosdoshme të kontabilistëve dhe auditorëve. Komisioni është kujdesur që anëtarët e shoqatës tonë në vazhdimësi kanë përmbyshur detyrimin e tyre që të mirëmbajnë njohuritë dhe aftësitë profesionale në nivelin e duhur për tu siguruar që klientët dhe punëdhënësit e tyre pranojnë shërbime profesionale të kualitetit të lartë. Komisioni gjithashtu inkurajon anëtarët tanë të veprojnë me kujdes dhe në pajtim me standardet e aplikueshme profesionale dhe teknike gjatë ofrimit të shërbimeve të tyre. Komisioni ka shqyrtuar ligjet dhe rregulloret e aplikueshme dhe të obligueshme në fushën e raportimit financiar pasi që mos-pajtueshmëria me to mund të diskreditoj profesionin.

Roli i ekspertëve financiar ka ndryshuar shumë. Bizneset tani më e kanë kuptuar vlerën e tyre duke i angazhuar edhe në zhvillimin e strategjisë dhe menaxhimin e biznesit. Mirëmbajtja e kompetencës profesionale dhe avancimi i anëtarëve tanë në një fushë shumë dinamike të standardeve profesionale mbetet sfida kryesore e punës së komisionit.

Raportet financiare të kualitetit të lartë dhe rritja e besueshmërisë së tyre nëpërmjet auditimit janë parakusht për krijimin e një ambient të favorshëm me qëllim të tërheqjes së investimeve. Shumë ekspertë tashmë e pranojnë që raportimi financiar dhe zhvillimi i tij është i ndërlidhur me rritjen ekonomike, andaj edhe ne si Komision do të mbesim të përkushtuar në zhvillimin e standardeve më të larta profesionale të raportimit financiar dhe auditimit.

Alban Lufi
Kryesues i Komisionit për Standarde Profesionale



■ Anëtarët e Komisionit për Standarde Profesionale

Nga e majta: Alban Lufi, Naim Avdiu, Lulzim Zeka

Raport nga Nën-Komisioni për Tatime



Nën-Komisioni për Tatime është pjesë e organizimit brenda SHKÇAK-së dhe funksionon në kuadër të Komisionit për Edukim Profesional, i cili sikurse komisionet tjera, çdo vit i përcakton objektivat e veta duke u bazuar në planin e punës si dhe në kërkesat që dalin nga DOA-të e FNK-së, standardet ndërkombëtare dhe ligjet e tatimet në Kosovë.

Roli i këtij Komisioni është specifik, duke marrë parasysh natyrën e çështjeve të cilat i shqyrton të cilat lidhen me monitorimin dhe rishikimin e draft propozimeve të legjislacionit tatimor në Kosovë i cili vazhdimisht pëson ndryshime. Në kuadër të këtij roli, nën-komisioni i njofton anëtarët për efektet e ndryshimeve në legjislacion si dhe i inkurajon ata për të komentuar dhe propozuar ndryshime kur anëtarët e konsiderojnë të rëndësishme.

Si rezultat i kësaj, gjatë vitit 2015 Nën-Komisioni për Tatime ka vazhduar të jetë monitorues i ndryshimeve të legjislacionit tatimor dhe ligjeve tjera që lidhen me profesionin tonë si dhe në vazhdimësi ka përcjellë shqetësimet e ardhura nga anëtarët e SHKÇAK-së.


Vlen të theksohet se me vetë iniciativë, Nën-Komisioni për Tatime ka krijuar grupin punues për rishikimin e Pakos së re Fiskale të propozuar nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) me ç'rast ka punuar në mbledhjen e komenteve nga tërë anëtarësia dhe paraqitjen e tyre në dokumente relevante.

Nën-Komisioni për Tatime ka vazhduar që në mënyrë profesionale përmes komunikimit dhe takimeve me institucionet qeverisëse të vendit ta ngris zërin dhe të kërkojë ndryshime të drejta dhe zbatim të duhur të legjislacionit tatimor në Kosovë.

Shyqiri Bytyqi
Kryesues i Nën-Komisionit për Tatime

Statistikat e vitit 2015


PËRQINDJA E TË ÇERTIFIKUARVE SIPAS GJINISË PËR VITET 2005 DHE 2015



Numri total i anëtarësisë së ShKÇAK qysh nga themelimi i saj deri në fund të vitit 2015 është 5973, ndërsaq prej tyre gjatë këtij viti kanë qenë aktiv 1384. Siç shihet në grafikun e mësipërm nga anëtarët aktivë, 46.53% janë femra dhe 53.47% janë meshkuj.

Duke marrë parasysh që tradicionalisht profesioni i kontabilitetit dhe auditimit është përfaqësuar nga gjinia mashkullore si në botë ashtu edhe në vend, ky profesion ka filluar të jetë më tërheqës edhe për femra. Kjo e përforcon faktin që femrat në Kosovë po emancipohen dita ditës më shumë.


PËRQINDJA E ANËTARËVE TË REGJISTRUAR SIPAS GJINISË



Për më tepër jo vetëm që përfaqësimi i të dy gjinive është i përafërt në tërësi për anëtarët e ShKÇAK, por po ashtu edhe numri i anëtarëve të certifikuar për të dy gjinitë është përafëruar ndër vite për të tre nivelet e programit certifikues për “Teknik i Kontabilitetit” (TK), “Kontabilist i Certifikuar” (KÇ) dhe “Auditor i Certifikuar” (AÇ). Për të demonstruar një gjë të tillë, grafiku më lart paraqet thirrjet e fituara për të tre nivelet gjatë vitit 2005 dhe 2015.

Nga totali i të certifikuarve për nivelin TK, në vitin 2005 kanë qenë 33% meshkuj ndërsa 67% femra, kurse në vitin 2015 diferenca është shumë më e vogël me 55% dhe 45% respektivisht. Për nivelin KÇ situata është e ngjashme ku në vitin 2005, 71% e të certifikuarve në këtë nivel janë meshkuj dhe 29% janë femra, por në vitin 2015 dallimi është vetëm 5% me 55% meshkuj dhe 45% femra që kanë fituar thirrje. Për nivelin AÇ, në vitin 2005 janë certifikuar 85% meshkuj dhe 15% femra, ndërsa në vitin 2015 janë certifikuar 50% meshkuj dhe 50% kanë femra.

PËRQINDJA E ANËTARËVE AKTIV TË PUNËSUAR NË SEKTORË TË NDRYSHËM




Grafiku i mësipërm shfaq grumbullimin e sektorëve të punësimit të anëtarëve tanë të cilët janë profesionistë të kontabilitetit dhe auditimit duke demonstruar se profesionistë të tillë janë të përfaqësuar në një gamë të gjerë të sektorëve të punës. Prandaj, ngritja e kapaciteteve në këtë profesion është i domosdoshëm në mënyrë që të gjithë sektorët të operojnë me cilësi të lartë. Pikërisht kjo është çfarë motivon ShKÇAK për të krijuar programe të reja për specializim në sektorë specifike, pra në atë privat dhe publik si dhe fusha specifike siç është auditimi i brendshëm.

Rezultatet e vitit 2015 tregojnë se 40.53% e anëtarëve janë të punësuar në kategorinë Biznes/Industri, ndërkohë që 13.37% e tyre janë të punësuar në sektorin publik. Po ashtu, 12.28% e tyre janë partnerë apo punonjës në firma të auditimit dhe kontabilitetit, 21.53% janë studentë, 0.94% punojnë në organizata ndërkombëtare, 1.23% në organizata jo-qeveritare dhe 9.10% e anëtarëve janë të angazhuar në sektorë të tjerë.

Një numër i konsiderueshëm i anëtarëve tanë janë po ashtu të përfshirë në sektorin Akademi/Edukim, përkatësisht 1.01% e tyre. Ky përfaqësim ndihmon në përafrimin e kurrikulumeve të kontabilitetit dhe auditimit në mes të edukimit akademik dhe profesional sipas Standardeve Ndërkombëtare të Edukimit në Kontabilitet (SNEK).

INTERESIMI I TË RINJVE PËR PROFESION




Përfaqësimi i anëtarëve aktiv të ShKÇAK sipas moshës është i paraqitur në grafikun e mësipërm ku krahasojmë dy vitet e fundit të punës, 2014 dhe 2015.

Në kategorinë nën 25-34 vjeç, përqindja e anëtarëve është rritur nga 66.74% në 70.38%. Kjo nënkupton se të rinjtë në Kosovë janë të interesuar të kualifikohen çdo herë e më shumë në kontabilitet dhe auditim duke marrë parasysh përfitimet që profilizimi në një fushë specifike sjell.

Gjithashtu edhe në dy kategoritë tjera përfaqësimi është mjaft i madh dhe dallimi në mes të anëtarëve aktivë të këtyre grup-moshave për vitet 2014 dhe 2015 është i vogël.

INTERESIMI I TË RINJVE PËR PROFESION



ShKÇAK iu jep studentëve dhe anëtarëve mundësi mjaft të mëdha për t'u treguar të suksesshëm duke ofruar tre afate të provimeve gjatë një viti. Në këtë mënyrë edhe atëherë kur studentët dhe anëtarët nuk arrijnë suksesin e dëshiruar gjatë një afati mund të përgatiten dhe të kenë mundësinë t'i nënshtrohen provimeve një apo dy afate më vonë.

Sa i përket identifikimit të afateve më të suksesshme në bazë të përqindjes së kalueshmërisë në provime, mesatarja më e lartë për tre vitet e fundit në të tre nivelet e programit certifikues është e afatit Shtator duke qenë gjithsej 46.67%, ndërsa afati Qershor dhe Dhjetor kanë një mesatare të kalueshmërisë për 43.67% dhe 42%. Megjithatë, të tre afatet paraqesin një kalueshmëri të konsiderueshme, prandaj edhe përkundër kostos së lartë për ShKÇAK-në, është vendosur që të vazhdojë mbajtjen e provimeve në të tre afatet.



Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës

**Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorëve të pavarur
31 Dhjetor 2015**

Përmbajtja:

Raporti i auditorëve të pavarur	3
Pasqyra e të ardhurave gjithpërfshirëse	5
Pasqyra e pozitës financiare	6
Pasqyra e ndryshimeve në fonde	7
Pasqyra e rrjedhës së paracë	8
Shënimet e pasqyrave financiare	9-21

Raporti i Auditorit të Pavarur

Për Këshillin e Shoqatës së Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës

Në kemi audituar pasqyrat financiare përcjellëse të Shoqatës së Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (tutje referohet si "Organizata" apo "ShKÇAK") që përbëhen nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 Dhjetor 2015, Pasqyra e të hyrave gjithëpërfshirëse, Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet dhe Pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin që përfundon, dhe pëmbledhjen e politikave kryesore të kontabilitetit dhe shënimet tjera sqaruese të përfshira në fq 5-21..

Përgjegjësi e menaxhmentit për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Kjo përgjegjësi përfshinë dizajnimin, implementimin dhe mirëmbajtjen e kontrollit të mbrendshëm që është i rëndësishëm për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare që janë të liruara nga gabimet materiale, qoftë nga mashtrimi apo gabimi, zgjedhjes dhe aplikimit të politikave të duhura kontabël, dhe bërja e vlerësimeve kontabël që janë të arsyeshme për rrethanat.

Përgjegjësi e Auditorit

Përgjegjësi e jona është të shprehim një mendim në këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne zhvilluam auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të pëmbushim kërkesat etike dhe planifikojmë dhe zhvillojmë auditimin për të arritur siguri të arsyeshme mbi atë se a janë pasqyrat financiare të liruara nga gabimet materiale. Auditimi përfshinë performimin e procedurave që të arrijmë evidencë audituese rreth shumave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varën nga gjykimi i auditorit, përfshirë vlerësimin e risikut të gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë nga gabimi apo mashtrimi.

Në bërjen e këtyre vlerësimeve të risikut, auditori merret në konsiderim kontrollin e mbrendshëm relevant për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare të Kompanisë në mënyrë që të dizajnoj procedurat e auditimit që janë të duhura për rrethanat, por jo për qëllim të dhënies së një mendimi në efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Kompanisë. Auditimi gjithashtu përfshinë vlerësimin e duhur të politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmëria e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimi i prezantimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare. Ne besojmë që dëshmia audituese që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e duhur që të ofrojmë bazë për opinionin tonë.

Opinion

Në opinionin tonë pasqyrat financiare të Organizatës prezantojnë në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Kompanisë më 31 Dhjetor 2015, si dhe performancën financiare të saj, ndryshimet në ekuitet dhe rrjedhën e parasë së saj për vitin që përfundon në këtë datë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.



Çabëfjet tjera

Pasqyrat financiare te Organizatës me dhe për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2014 janë audituar nga auditor tjetër opinioni i të cileve mbi keto pasqyra ka qen i pakualifikuar. .

Audit & Conto,


Ymer Shatri
31 Mars 2016



Pasqyra e të ardhurave gjithpërfshirëse

Shënime	(në Euro)	
	Viti i përfunduar me 31 Dhjetor	
	2015	2014
		Rideklarim
Të hyrat operative		
Të hyrat nga edukimi	3	292,784
Të hyrat nga anëtarësimi	3	103,167
Të hyrat tjera	3	4,877
Të hyrat nga BQK	3	6,303
Të hyrat nga kontrolli i cilësisë	3	3,100
	399,051	476,031
Shpenzimet		
Shpenzimet administrative	4	150,619
Shpenzimet e trajnimit	5	119,178
Shpenzimet e provimeve	6	21,158
Shërbimet për anëtarë	7	112,498
	403,453	438,628
Tëprica (deficiti) e akumuluar e të hyrave	(4,402)	37,403

Andiana Bunjaku
Drejtoreshë Ekzekutive



Shënime shpjeguese nga faqe 9 në faqe 21 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare

5

Pasqyra e pozitës financiare

	Shënimet	2015	(në Euro) Me 31 Dhjetor 2014 Rideklarim
Pasuritë qarkulluese			
Paraja dhe ekuivalentet e parash	8	501,269	501,464
Parapagimet dhe të arkëtueshmet tjera	9	2,963	4,134
Të arkëtueshmet e grantit BQK		5,838	5,838
		510,070	511,436
Pasuritë jo-qarkulluese			
Prona, implantet dhe pajisjet	10	8,375	8,957
Pasuritë e paprekshme	11	460	690
		8,835	9,647
Totali i pasurive		518,905	521,083
Detyrimet afat-shkurta			
Detyrimet tregtare dhe të tjera	12	13,940	10,754
Të hyrat e shlyra	13	83,506	84,468
		97,446	95,222
Fondet			
Tepësia e akumuluar e të hyrave		421,459	425,861
		421,459	425,861
Totali i detyrimeve dhe fondeve		518,905	521,083

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Menaxhmenti i ShKÇAK me 30 Mars 2016 dhe janë nënshkruar nga,

Ardiana Bunjaku
Drejtor i përgjithshëm Ekzekutiv



Shënimet shpjeguese nga faqe 9 në faqe 21 janë pjesë integrale e kësaj pasqyre financiare

6

Pasqyra e Ndryshimeve në Fonde

	Me 31 Dhjetor 2015	(në Euro) Me 31 Dhjetor 2014
Me 01 Janar	425,861	Rideklarim 388,458
Teprica (suficit) e të hyrave për vitin	(4,402)	37,403
Teprica e akumuluar e të hyrave Me 31 Dhjetor	421,459	425,861

Pasqyra e Rrjedhës së Parasë

	Shënime	(në Euro) Viti i përfunduar me 31 Dhjetor	2014 Rideklarim
AKTIVITETET OPERATIVE			
Fitimi / (humbja) e vitit		(4,402)	37,403
Zhvlerësimi dhe amortizimi		8,291	16,638
Të arkëtueshmet		1,171	8,082
Detyrimet tregëtare dhe të tjera		3,185	(5,606)
Të hyra të shtryra		(961)	8,868
Paraja neto nga aktivitetet operative		7,284	65,386
AKTIVITETET INVESTUESE			
Blerja e pajisjeve		(7,480)	(3,190)
Paraja neto nga aktivitetet investuese		(7,480)	(3,190)
AKTIVITETET FINANCUESE			
			-
Rrjedha neto e parasë për periudhën		(196)	62,196
Gjendja e parasë në fillim		501,464	439,268
Gjendja e parasë në fund	8	501,269	501,464

Shënime shpjeguese nga faqe 9 në faqe 21 janë pjesë integrale e kësaj pasqyre financiare

8

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare

1. Të përgjithshme

Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës ("SHKÇAK" ose "Organizata") është organizatë jo profitabile e themeluar në pajtueshmëri me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 1999/22 dhe Ligji Nr.03/L- 134 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare. SHKÇAK është themeluar për qëllim të:

- Profesionalizmit të Ndërsjellë: për të përkrahur, mbrojtur dhe avancuar karakterin, statusin dhe interesat e profesionit të kontabilitetit në përqëndruesi dhe të kontabilistëve e auditorëve në veçanti që janë anëtarë të SHKÇAK;
- Rritjes Profesionale: që të lehtësojë mirëmbajtjen dhe zhvillimin e kompetencave të anëtarëve përgjatë karrierës së tyre;
- Integritetit: për të mbajtur nivelin më të lartë të standardeve profesionale dhe integritetit të anëtarëve në interes të komunitetit; dhe
- Përfaqësimit: për të përfaqësuar profesionin në komunitet.

Me 31 dhjetor 2015 dhe 2014, Organizata ka kryer aktivitetet me 15 dhe 13 të punësuar përkatësish.

2 Politikat e kontabilitetit

Në vazhdim janë paraqitur politikat kryesore të kontabilitetit që janë adoptuar në përgatitjen e këtyra pasqyrave financiare:

2.1 Baza e përgatitjes dhe deklarata e pajtueshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me Standardet e Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me konventën e kostos historike.

Pasqyrat financiare janë përgatitur për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2015 dhe 2014. Të dhënat aktuale dhe krahasuese të paraqitura në këto pasqyra financiare janë shprehur në Euro.

2.2 Rideklarimi i zërave në pasqyrat financiare

Menaxhmenti i SCAAK ka rideklaruat zërat e të hyrave nga provimet dhe të hyrave të shtryra nga provimet për vitin 2014. Rideklarimi ka efekt në zvogëlimin e tepriçës së akumuluar në vlerë prej 3,300 Euro dhe rritjen e të hyrave të shtryra nga provimet në vlerë prej 3,300 Euro. Ky rideklarim është rezultat i ndryshimit të mënyrës së njohjes së të hyrave (nga provimet) nga të hyra grupore në të hyra individuale për secilin student. Aty ku ka qenë e nevojshme, të dhënat krahasuese janë harmonizuar për t'u përshtatur më ndryshimet në prezantimin për vitin aktual.

2.3 Valuta funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare janë të paraqitura në Euro, e cila është valuta funksionale e organizatës.

2.4 Zbatimi i standardeve të reja dhe të ndryshuara

Organizata ka zbatuar, për herë të parë, disa standarde dhe ndryshime në standard, të cilat janë efektive për periudhat që fillojnë me ose pas 1 janar 2015. Organizata nuk ka adoptuar ndonjë standard tjetër, interpretim ose ndryshim që është lëshuar por që nuk ka hyrë në fuqi. Disa prej ndryshimeve të zbatohen për herë të parë në vitin 2015. Mirëpo nuk kanë ndikim në pasqyrat financiare të Organizatës prandaj nuk janë shpalosur. Natyra dhe efekti i këtyre ndryshimeve janë shpalosur më poshtë. Edhe pse këto standard dhe ndryshime të reja zbatohen për herë të parë në vitin 2015, ato nuk kanë ndikim material në pasqyrat financiare të Organizatës.

Amendamentet në SNK 19 Planet e definuara të përfuturit

Kontributet e të punësuarve SNK 19 kërkon që entiteti të konsideroj kontributet nga të punësuarit ose palët e treta kur trajton planet e definuara të përfuturit. Kur kontributet janë të lidhura me shërbimin, ato duhet të atribuohen për periudhat e shërbimit si përfutim negativ. Këto amendamente qartësojnë se, nëse shumta e kontributeve është e pavatuar nga numri i viteve të shërbimit, entiteti lejohet të njoh këto kontribute si zvogëlim në koston e shërbimeve në periudhën në të cilën është ofruar shërbimi, në vend që të alokohen kontributet në periudhat e shërbimit. Ky amendament është efektiv për periudhat me ose pas 1 korrik 2014. Ky amendament nuk është relevant për Organizatën.

Përmirësimet vjetore Ciklidi 2010-2012

IFRS 2 Pagesat e Baza në Aksione

Përkufizimet e kushteve për tregun dhe kushtëzime kanë qartësuar duke përkufizuar ndarazi kushtet e performancës dhe kushtet e shërbimit, të dyja këto që më herët janë inkorporuar brenda përkufizimit të kushteve të kushtëzimit pa u qartësuar në mënyrë specifike.

SNRF 3 – Kombinimet e biznesit

Amendamenti zbatohet për shifrat në të ardhmen dhe sqaron se të gjitha konsideratat kontingjente të klasifikuara si detyrime (ose pasuri) që paragjiten nga kombinimet e biznesit duhet që në të ardhmen të maten sipas vlerës fer përmes fitimit ose humbjes pa marrë parasysh nëse janë në apo jo në fushëveprimin e SNK 39. Organizata nuk është grup prandaj ky amendament nuk është relevant për organizatën.

SNRF 8 – Segmentet operative

Amendamentet zbatohen në mënyrë retrospektive dhe qartësojnë se:

- Entiteti duhet të shpalos gjykimet e bëra nga menaxhmenti në zbatimin e kritereve të agregimit në paragrafin 12 të SNRF 8, përfshirë një shpjegim të shkurt për segmentet operative të cilat janë agreguar dhe karakteristikat ekonomike (psh shitjet dhe marzhat bruto) të përdorura për të vlerësuar nëse segmentet janë 'të ngjashme'.
- Harmonizimi i pasurive të segmenteve me pasuritë totale kërkolet të shpaloset vetëm nëse harmonizimi është raportuar te vendimmarrësi kryesor operativ, ngjashëm me kërkesat për shpalosje të detyrimeve. Organizata nuk ka zbatuar kriterin e agregimit në SNRF 8.12.

Organizata nuk ka segmente operative prandaj ky amendament nuk është relevant për organizatën.

Përmirësimet vjetore Ciklidi 2011-2013

Këto përmirësimet kanë hyrë në fuqi nga 1 korrik 2014 dhe Organizata i ka zbatuar ato për herë të parë në këtë pasqyrë financiare. Këto përfshijnë:

SNRF 3 – Kombinimet e biznesit

Amendamenti zbatohet në mënyrë prospective dhe qartësoh fushëveprimin brenda SNRF 3

- Atrazhimet e përbashkëta, jo vetëm investimet e përbashkëta, janë jashtë fushëveprimit të SNRF 3.
- Ky përjashtim i fushëveprimit zbatohet vetëm në kontabilitetin për pasqyrat financiare të arranzhimeve të përbashkëta dhe Organizata nuk është një arranzhim i përbashët, prandaj ky amendament nuk është relevant për Organizatën.

SNRF - 13 Matja sipas vlerës fer

Amendamenti zbatohet në mënyrë prospective dhe qartëson se portfoliot e përjashtimeve në SNRF 13 mund të zbatohen jo vetëm në pasuritë dhe detyrimet financiare por gjithashtu në kontratat tjera që i nënshtrohen SNK 39. Organizata nuk zbaton portfoliot e përjashtimeve sipas SNRF 13.

SNK 16 Prona, impiantet dhe pajisjet dhe SNK 38 Pasuritë e patrupëzuara

Amendamenti zbatohet në mënyrë retrospective dhe qartëson në SNK 16 dhe SNK 38 se pasuritë mund të rivilersohen duke iu referuar të dhënave të vëzhgueshme ose duke e korrigjuar vlerën bartëse bruto të pasurisë me vlerën e tregut të pasurisë ose duke e përcaktuar vlerën e tregut të vlerës bartëse proporcionalisht ashtu që vlera bartëse që rezulton të jetë e barabartë me vlerën e tregut. Përveç kësaj, zhvlerësimi ose amortizimi i akumuluar është diferenca në mes të shumës bruto se vlerës bartëse të pasurisë. Ky amendament nuk ka pasur efekt në korrigjimet rivilersuese të organizatës në periudhën aktuale.

2.5 Ndryshimet në politikat kontabël dhe shpalosjet

SNK 24 Shpalosjet e palëve të lidhura

Ky amendament zbatohet në mënyrë retrospective dhe qartëson se entiteti menaxhues (një entitet që ofron shërbime të personelit kyç menaxherial) është palë e lidhur dhe i nënshtrohet shpalosjes së palëve të lidhura. Përveç kësaj, entiteti që përdor entitet menaxhues kërkohet të shpalos shpenzimet për këto shërbime menaxheriale. Ky amendament nuk është relevant për Organizatën pasi që nuk pranon shërbime menaxheriale nga entitetet tjera.

SNK 40 Pronat investuese

Përshkrimi i shërbimeve ndihmëse në SNK 40 bën dallimin në mes të pronave investuese dhe pronave të zëna nga pronarët (dualit prona, impiantet dhe pajisjet). Amendamenti zbatohet në mënyrë prospective dhe sqaron se SNRF 3, dhe jo përshkrimi i shërbimeve ndihmëse në SNK 40, përdoret në përcaktimin nëse transaksioni është blerje e një pasurie ose një kombinim i biznesit. Në periudhat e mëparshme Organizata është mbështetur në SNRF 3 e jo në SNK 40 në përcaktimin nëse një blerje është pasuri ose kombinim i biznesit. Prandaj ky amendament nuk ndikon në politikat e kontabilitetit të Organizatës.

2.6 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë balancet e parasë së gatshme dhe ato të depozituara në bankat vendore.

2.7 Shkëmbimet në valuta të huaja

Transaksionet në valuta të huaja janë regjistruar në pajtueshmëri me normën valide të këmbimit në datën e transaksionit. Ndryshimet janë regjistruar në pasqyrën e të ardhurave si fitime/humbje.

2.8 Kundërbalancimi (offsetting)

Pasuritë financiare dhe detyrimet janë kundërbalancuar dhe raportuar në bilancin e gjendjes atëherë kur ka të drejtë të imponueshme ligjore për të kundërbalancuar shumat e njohura dhe ka synim të vendoset në baza neto, ose të realizojë pasurinë dhe të shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë.

2.9 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë njohur atëherë kur është e mundur që benefitet e ardhshme ekonomike do të rrjedhin në Organizatë dhe këto benefitet të mund të maten besueshëm.

Organizata njeh të ardhurat duke i ngarkuar llojet në vazhdim:

- Tarifat e anëtarisë dhe tarifit të edukimit janë njohur fillimisht kur është lëshuar faktura. Të hyrat janë rregulluar në fund të vitit për të reflektuar vetëm të hyrat e situara gjatë vitit.
- Të hyrat nga tarifit të edukimit dhe anëtarimit janë shtyrë për pagesat e pranura për parashënime.

2.10 Prona, implantet dhe pajisjet

Prona, implantet dhe pajisjet janë bartur në kosto historike minus zhvlersimi i akumuluar. Kostoja historike përfshin të gjitha shpenzimet direkt të atribuueshme në përvetësimin e zërit.

Zhvlersimi është ngarkuar duke përdorur metodën e bilancit zbritës në normat e paracaktuara në mënyrë që të alokohet kostoja e pronës, implantëve dhe pajisjeve përgjatë jetës së tyre të përdorimit.

Në vazhdim është paraqitur jeta e përafërt e përdorimit të aplikuar ndaj zërave të rëndësishëm të pronës, implantëve dhe pajisjeve:

2.11 Prona, implantet dhe pajisjet (vazhdim)

	2015	2014
Mobiljet dhe pajisjet	2-5 vite	2-5 vite
Pajisjet e TI nën 1,000 Euro	3 vite	3 vite
Veturat	5 vite	5 vite

Kostot pasuese janë përfshirë në vlerën bartëse të pasurive ose janë njohur si pasuri të ndara, si ka qenë e përshatshme, vetëm kur është e mundur që benefitet e ardhshme ekonomike të lidhura me zërit do të rrjedhin në Organizatë dhe kostoja e zërit mund të matet me besueshmëri. Të gjitha riparimet tjera dhe mirëmbajtja janë ngarkuar në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës financiare në të cilën kanë ndodhur. Fitimet dhe humbjet mbi heqjet janë përcaktuar duke krahasuar shumat me vlerat bartëse. Këto janë përfshirë në pasqyrën e të ardhurave.

2.12 Pasuritë e paprekshme

Pasuritë e paprekshme me jetëgjatësi të caktuar të cilat janë blerë veç e veç mbahen me kosto minus amortizimi i akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga dëmtimi. Amortizimi njihet në baza të njehta përgjatë jetëgjatësisë së vlerësuar të pasurisë.

Pasuritë e pa prekshme të Organizatës përbëjnë Softuerë kompjuterik.

Amortizimi është ngarkuar duke përdorur metodën drejtvizore brenda pesë viteve përgjatë jetës së tyre të përdorimit.

2.13 Dëmtimi i pasurive të prekshme dhe të paprekshme

Në fund të secilës periudhë raportuese, Organizata rishikon shumat bartëse të pasurive të prekshme dhe të pa prekshme të saj për të përcaktuar nëse ka ndonjë të dëshmi që ato pasuri kanë humbje nga dëmtimi. Nëse ekziston ndonjë informacion i tillë, shumat e rikuperueshme e pasurisë vlerësohet në mënyrë që të përcaktohet masa e humbjeve nga dëmtimi (nëse ka).

Shumat e rikuperueshme është më e lartë se sa vlera e drejtë minus shpenzimet e lundhjes dhe vlera në përdorim. Në vlerësimin e vlerës së përdorimit, rrjedhat e ardhshme të pasurisë së gatshme janë të skontuara në vlerën e tyre të tanishme duke përdorur normën e skontimit të para-tatimit e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të pasurisë dhe riskun specifik të pasurisë për të cilën vlerësimet e rrjedheve të ardhshme të pasurisë nuk kanë qenë të rregulluara.

Nëse shumta e rikuperueshme e një pasurie vlerësohet të jetë më e vogël se vlera bartëse e saj, vlera bartëse e pasurisë zvogëlohet në shumën e rikuperueshme të saj. Një humbje nga dëmtimi njihet menjëherë në fitim apo humbje, përveç rastit kur pasuria përkatëse mbahet me shumën e rivlerësuar, ku në këtë rast humbja nga dëmtimi trajtohet si rënje e rivlerësimit.

Pasuritë që janë subjekt i amortizimit janë rishikuar për dëmtim kurdo që ngjarjet apo ndryshimet në rrethana tregojnë se vlera bartëse mund të mos rikuperohet. Vlera bartëse e një pasurie është shënuar menjëherë në vlerë të rikuperueshme nëse vlera bartëse e një pasurie është më e lartë se vlera e rikuperueshme që është vlerësuar të jetë. Vlera e rikuperueshme është më e lartë e vlerës reale të pasurisë minus kosto e shitjes dhe vlerës në përdorim.

2.14 Grantet

Grantet e Qeverisë njihen në fitim ose humbje në baza sistematike përgjatë periudhës në të cilën Organizata i njeh si shpenzime koston përkatëse për të cilat grantet janë destinuar për kompenzim. Në mënyrë specifike grantet e Qeverisë, për të cilat kushti primar është që Organizata duhet të i përfutoj, konstruktiv apo të i njeh pasuritë jo-qatkulluese si të hyra të shytyra në pasqyrën e pozitës financiare dhe të transferohen në fitim apo humbje në baza sistematike dhe racionale përgjatë jetës së përdorimit të pasurisë përkatëse.

Grantet janë njohur vetëm kur ka siguri të arsyeshme se:

- Organizata do të përmbushë të gjitha kushtet e bashkangjitura atyre; dhe
- Grantet do të pranohen.

Grantet operative janë njohur si e hyrë përgjatë periudhës së nevojshme për t'i lidhur ato me koston, për të cilat janë menduar të kompensohen, në bazë sistematike. Grantet e shënuara për përvetësimin e pasurive janë shytyrë dhe njohur si e hyrë përgjatë kohës së përdorimit të pasurisë përkatëse.

2.15 Instrumentet Financiare

Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare njihen kur Organizata bëhet pjesë e marrëveshjeve kontraktuale të instrumenteve.

Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare fillimisht maten me vlerën e tyre të drejtë. Kostot e transakcioneve të cilat i atribuohen direkt blerjes apo emetimit të pasurive financiare dhe detyrimeve financiare u shtohen apo i zbriten vlerës së drejtë të pasurive financiare apo detyrimeve financiare, në mënyrë të përshtatshme në njohjen fillestare. Kostot e transakcioneve të atribuueshme direkt blerjes së pasurive financiare apo detyrimeve financiare në vlerën e tyre të drejtë përmes fitimit apo humbjes njihen menjëherë në fitim apo humbje.

Pasuritë financiare

Pasuritë financiare klasifikohen në kategori specifike siç janë: pasuritë financiare 'në vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes' (VDPFI), investimet 'e mbajtura deri në maturim', pasuritë financiare 'të gatshme-për-shitje' (GPSH) dhe 'huatë dhe të arkëtueshme'. Klasifikimi varet nga natyra dhe qëllimi i pasurive financiare dhe përcaktohet në kohën e njohjes fillestare. Të gjitha blerjet apo shitjet e rregullta të pasurive financiare njihen në bazë të datës së tregtimit. Blerjet apo shitjet në mënyrën e rregullt janë blerjet apo shitjet e pasurive financiare të cilat kërkojnë shpërndarjen e pasurive brenda kohës së caktuar nga rregullimi apo marrëveshja në treg.

Metoda efektive e interesit

Metoda efektive e interesit është metoda e kalkulimit të koston së amortizuar të një instrumenti të bordhit dhe të alokimit të të hyrave nga interesi përgjatë periudhës përkatëse. Norma efektive e interesit e cila saktësisht skanton arkëtimet e ardhshme të pasasë, të vlerësuar përmes jetës së pritur të instrumentit të

borxhit, apo, ku është e përshatshme, një periudhë më të shkurtër, vlerës neto bartëse në njohjen fillestare.
Të hyrat njihen në baza të interesit efektiv për instrumentet e borxhit, të ndryshme nga ato të cilat klasifikohen si VDPFH.

Pasuritë financiare të VDPFH

Pasuritë financiare klasifikohen si VDPFH kur pasuria financiare është (i) konsideratë kontigjente e cila mund të paguhet nga një blerje si pjesë e kombinimit të biznesit për të cilën aplikohet SNRF 3, (ii) të mbajtura për tregtim, ose (iii) janë të përcaktuara si VDPFH.

Investimet e mbajtura deri në maturim

Investimet e mbajtura deri në maturim janë pasuri financiare jo-derivate me pagesa fikse apo të përcaktueshme dhe data fikse të maturimit, ku Organizata ka qëllim pozitiv dhe mundësi të i mbaj deri në maturim. Pas njohjes fillestare, investimet e mbajtura deri në maturim vlerësohen sipas kostos së amortizimit duke përdorur metodën efektive të interesit minus çfarëdo dëmtimi.

Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme

Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme janë pasuri financiare jo-derivate me pagesa fikse apo të përcaktueshme të cilat nuk janë të kuotuar në tregun aktiv. Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme (duke përfshirë të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera, parane e gatshme dhe parane në bankë) vlerësohen sipas kostos së amortizuar duke përdorur metodën efektive të interesit, minus çfarëdo dëmtimi.

Pasuritë financiare të gatshme-për-shitje (pasuritë financiare GPSH)

Pasuritë financiare GPSH janë jo-derivate të cilat janë të përcaktuara sikur GPSH apo nuk klasifikohen si (a) huatë dhe llogaritë e arkëtueshme, (b) investimet që mbahen deri në maturim apo (c) pasuritë financiare në vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes.

Dëmtimi i pasurive financiare

Pasuritë financiare, të ndryshme nga VDPFH, vlerësohen si indikatorë të dëmtimit në fund të secilës periudhë raportuese. Pasuritë financiare konsiderohen të dëmtuara kur ka dëshmi që, si rezultat i një apo më shumë ngjarjeve që ndodhin pas njohjes fillestare të pasurive financiare, janë ndikuar rrjedhat e ardhshme të parasë së gatshme të vlerësuara të investimeve.

Për instrumentet e ekuitetit GPSH, një rënje domethënëse apo e zgjatur në vlerën e drejtë të letërës me vlerë pothuajse tërësisht të tij konsiderohet të jetë dështim i dëmtimit.

Për të gjitha pasuritë e tjera financiare, dështim i vlefshme të dëmtimit mund të përfshijë:

- Vështirësi financiare domethënëse të emetuesit apo të palës tjetër;
- Prishja e kontratës, siç është mospagesa apo shkelja në pagesat e interesit apo kryegjës;
- Mundësia që huamarrësi të ketë falimentim apo ri-organizim financiar; apo
- Humbja e një tregu aktiv për pasuritë financiare për shkak të vështirësive financiare.

Për disa kategori të pasurive financiare, siç janë llogaritë e arkëtueshme tregtare, pasuritë vlerësohen për dëmtim në baza kolektive edhe nëse individualisht nuk janë vlerësuar për dëmtim. Dëshmitë e vlefshme të dëmtimit për një portfolio të llogarive të arkëtueshme mund të përfshijnë përvojën e kaluar të mbledhjes së pagesave të Organizatës, një rritje në numrin e pagesa të vonuara në portfolio, si dhe ndryshimet e dukshme në kushtet ekonomike kombëtare apo lokale të cilat lidhen me mospagesën e llogarive të arkëtueshme.

Për pasuritë financiare të cilat vlerësohen sipas kostos së amortizimit, shuma e njohur e humbjeve nga dëmtimi është diferenca në mes të shumës bartëse të pasurisë në vlerën e tanishme dhe vlerës së tanishme të rrjedhës së parasë, e skontuar në normën efektive origjinale të pasurisë financiare.

Për pasuritë financiare që vlerësohen sipas kostos së amortizuar, nëse, në një periudhë pasuese, shuma e humbjes nga dëmtimi bie, dhe rënja mund të jetë e lidhur objektivisht me një ngjarje që ndodhë pas njohjes së dëmtimit, humbja nga dëmtimi i njohur në fillim kthehet mbapsht përmes fitimit apo humbjes deri në masën që shuma e bartur e investimit në datën e dëmtimit të kthyer mbapsht nuk e tejkalon shumën e kostos së amortizuar që do të kishte qenë nëse dëmtimi nuk do të ishte njohur.

Çojohja e pasurive financiare

Organizata e çojeh pasurisë financiare kur të drejtat kontraktuale të rrjedhës së parësë për largimin e pasurive, apo transferimin e pasurisë financiare dhe kryesisht të gjitha rreziqet dhe shpërblimet e pronësisë së pasurisë i kalojnë palës tjetër.

Në çojohje të plotë të pasurisë financiar, diferenca në mes të shumës bartëse të pasurisë dhe shumës së konsideratës së pranuar dhe llogarive të arkëtueshme dhe humbjet apo fitimet kumulative që ishin njohur në pasqyrën tjetër gjithëpërfshirëse dhe të akumuluar në ekuitet njihet në fitim apo humbje.

Detyrimet financiare

Detyrimet financiare klasifikohen si detyrime financiare "VDPFH" apo "detyrime financiare të tjera".

Detyrimet financiare VDPFH

Detyrimet financiare klasifikohen si VDPFH kur detyrimi financiar është (i) konsiderata kontigjente e cila mund të paguhet në blerje si pjesë e kombinimit biznesor për të cilën aplikohet SNRF 3, (ii) të mbajtura për tregtim, apo (iii) është e përcaktuar si VDPFH.

Detyrimet financiare të tjera

Detyrimet financiare të tjera (përfshirë huazimet dhe të pagueshmet tregtare dhe të tjera) janë më pas të vlerësuar me koston së amortizuar duke përdorur metodën efektive të interesit.

Çojohja e detyrimeve financiare

Organizata i çojeh detyrimet financiare kur, dhe vetëm kur obligimet e Organizatës shkarohen, anulohen apo shuhet. Diferenca në mes të shumës bartëse të detyrimit financiar të çojohur dhe konsiderata e paguar dhe të pagueshmet njëlloj tek fitimi dhe humbja.

2.16 Shpenzimet

Shpenzimet janë njohur kur kanë ndodhur.

2.17 Benefitet e të punësuarve

Organizata kontribon në planet pas pensionale të të punësuarve të saj siç përkrahën nga legjislacioni i sigurimit i miratuar nga ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës. Kontributet, e bazuara në paga, u janë bërë organizatës nacionale që janë përgjegjëse për pagesën e pensioneve. Nuk ka detyrim shtesë në lidhje me këto plane dhe kështu këto skema janë konsideruar si plane të definuara të kontributeve. Organizata nuk ka benefite pas pensionale ndaj të punësuarve të saj.

2.18 Tatimi në fitim

SHKÇAK është krijuar si organizatë jo profitabile dhe prandaj, është e liruar nga tatimi në të ardhura të korporatave. SHKÇAK gjatë vitit 2015 nuk ka gjeneruar të hyra tjera nga aktivitetet ekonomike të cilat i nënshtrohen tatimit në të ardhura të korporatave.

Organizata nuk ka njohur ndonjë detyrim apo pasuri të shtyrë tatimor me 31 Dhjetor 2015 dhe 2014, siç nuk ka ndryshime të përkohshme ekzistuese në ato data.

2.19 Menaxhimi i riskut financiar

Risku kreditor

Risku kreditor paraqet riskun që pala tjetër të dështoj në kryerjen e obligimeve kontraktuale që rezultojn në humbje financiare të Organizatës. Organizata ka adoptuar një politikë për të kontraktuar vetëm palët e besueshme dhe të siguroj dëshmi të mjaftueshme, për të zvogëluar rrezikun e humbjes financiare nga dështimi në kryerjen e pagesave. Organizata siguron që një vetëm të arkëtueshmet nga individët e

organizatave të mirë-formuara në Kosovë. Ekspozimi ndaj kredive kontrollohet në baza periodike nga Zyrtari Ekzekutiv dhe Këshilli.

Risku i tregut

Risku i tregut është risku i cili ndryshon me ndryshimin e çmimeve të tregut, siç janë ndryshimi i kursit valutator i jashtëm dhe i normave të interesit që do të ndikojnë në të hyrat e Organizatës apo vlerën e zotërimeve të instrumenteve financiare të saj. Qëllimi i menaxhimit të riskut të tregut është menaxhimi dhe kontrollimi i ekspozimit të riskut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, gjatë optimizimit të kthimit. Përdorja nuk ka transaksione materiale në valutën e huaj dhe përdorja nuk ka interes në fondet e huazuara nga institucionet financiare lokale dhe të jashtme në datën e pozicionit financiar. Organizata nuk ekspozohet ndaj çfarëdo ndryshimi të kursit të këmbimit dhe rrezikut të normave të interesit.

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Pasuritë		
Paraja e gatshme dhe në bankë	501,269	501,464
Totali	501,269	501,464

Risku i likuiditetit

Përgjegësia themelore për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit i takon Këshillit të ShKÇAK. Menaxhimi i matur i riskut të likuiditetit nënkupton mbajtjen e mjaftueshme të parasë së gatshme, disponueshmëri të fondeve përmes lehtësirave për kredi dhe mundësisë për t'i mbledhur në kohën e duhur, brenda kushteve të shumave të vendosura për shkak të konsumatorëve. Organizata menaxhon riskun e likuiditetit duke mbajtur rezerva të mjaftueshme, lehtësira bankare dhe duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme planifikimin dhe rrjedhën aktuale të parasë, dhe duke koordinuar profilet e maturitetit të pasurive dhe detyrimeve financiare.

Tabelat në vijim paraqesin maturitetet kontraktuale të mbetura të pasurive financiare dhe detyrimeve financiare të Organizatës. Tabelat përgatiten në baza të rrjedhave të parasë të paskontuara të detyrimeve financiare.

	31 Dhjetor 2015			
	Qarkulluese Deri në 1 vit (Euro)	Jo - qarkulluese 1 deri 2 vite (Euro)	2 deri 5 vite (Euro)	Mbi 5 vite (Euro)
Pasuritë financiare				
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj	501,269	-	-	-
Llogaritë e arkëtueshme	2,963	-	-	-
Totali i pasurisë	504,232	-	-	-
Detyrimet financiare				
Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet tjera	13,940	-	-	-
Totali i detyrimeve financiare	13,940	-	-	-

	31 Dhjetor 2014			
	Qarkulluese Deri në 1 vit (Euro)	Jo - qarkulluese 1 deri 2 vite (Euro)	2 deri 5 vite (Euro)	Mbi 5 vite (Euro)
Pasuritë financiare				
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj	501,464	-	-	-
Llogaritë e arkëtueshme	4,134	-	-	-
Totali i pasurive financiare	505,598	-	-	-
Detyrimet financiare				
Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet tjera	10,754	-	-	-
Totali i detyrimeve financiare	10,754	-	-	-

Instrumentet financiare që nuk paraqiten në vlerën e drejtë

Tabela në vijim përmbledhë vlerat bartëse dhe vlerat e drejta të pasurive dhe detyrimeve financiare që nuk paraqiten në Pasqyrën e pozitës financiare në vlerën e tyre të drejtë:

	Vlera bartëse 2015	Vlera e drejtë 2015	Vlera bartëse 2014	Vlera e drejtë 2014
Pasuritë financiare				
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj	501,269	501,269	501,464	501,464
Llogaritë e arkëtueshme	2,963	2,963	4,134	4,134
Totali i pasurive financiare	504,232	504,232	505,598	505,598
Detyrimet financiare				
Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet tjera	13,940	13,940	10,754	10,754
Totali i detyrimeve financiare	13,940	13,940	10,754	10,754

2.20 Ngjarjet pasuese

Ngjarjet pas përfundimit të vitit që ofrojnë informacion shtesë në lidhje me pozicionin e Organizatës në datën e bilancit të gjendjes (ngjarjet rregulluese) janë reflektuar në pasqyrat financiare. Ngjarje pas përfundimit të vitit që nuk janë ngjarje rregulluese janë shpalosur në pasqyra financiare kur kanë qenë materiale.

3 Të hyrat

	Viti i përfunduar me 31 Dhjetor 2015	(në Euro) Viti i përfunduar me 31 Dhjetor 2014
Regjistrimi	8,950	8,690
Trajnimi	169,520	159,974
Provimet	75,556	76,120
Edukimi i Vazhdueshëm Profesional	25,983	26,395
Trajnimi - ZAP	5,275	74,000
Provimet - ZAP	7,500	14,675
Gjithsej të hyra nga edukimi	292,784	359,854
Të hyrat nga anëtarësimi	103,167	104,997
Gjithsej të hyrat nga anëtarësimi	103,167	104,997
Të hyrat tjera		4,877
Të hyra nga grati BQK		6,303
Të hyrat nga kontrolli i cilësisë	3,100	
Gjithsej të hyrat	399,051	476,031

4 Shpenzimet administrative

	(në Euro)	
	Viti i përfunduar me 31 Dhjetor 2015	Viti i përfunduar me 31 Dhjetor 2014
Pagat	101,321	104,860
Zhvlersimi (Shënim 10)	8,061	8,430
Amortizimi (Shënim 11)	230	8,208
Qiraja	10,800	10,850
Shërbimet komunale	4,379	3,518
Shpenzime të komunikimit	2,354	3,083
Marketingu	2,471	2,787
Furnizime të zyrës	3,476	3,521
Auditimi	1,195	1,800
Renovimi i zyrës	662	25
Sigurimi shëndetësor	4,283	4,715
Mirëmbajtja e veturës	2,446	2,471
Zhvillimi i personelit		1,000
Ueb-faqja dhe TI	4,794	5,079
Shpen.e borxheve të kështjës	180	1,020
Shpenzimet e nllcencimit në KKRF		3,931
Tjera	3,967	4,802
Gjithsej shpenzimet administrative	150,619	170,100

5 Shpenzimet e trajnimit

Shpenzimet e trajnimit për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2015 dhe 2014 ishin si në vazhdim:

	(në Euro)	
	Viti i përfunduar me 31 Dhjetor 2015	Viti i përfunduar me 31 Dhjetor 2014
Mbajtja e trajnimeve	81,990	82,013
Qiraja	22,700	21,600
Shtypja e materialeve	10,010	12,126
Shpenzimet e trajnimit - ZAP	1,575	41,215
Shpenzimet e rrymes - trajnime	1,397	1,018
Tjera	1,506	1,834
Gjithsej shpenzimet e trajnimeve	119,178	159,806

6 Shpenzimet e provimeve

	Viti i përfunduar me 31 Dhjetor 2015	(në Euro) Viti i përfunduar me 31 Dhjetor 2014
Përpilimi, korrigjimi	9,484	11,217
Mbikqyrja	6,049	5,162
Qiraja	2,160	2,376
Shërbimet	2,288	2,071
Shpenzimet e provimeve - ZAP	660	14,085
Tjera	517	86
Gjithsej shpenzimet e provimeve	21,158	34,997

7 Shërbimi për anëtarë

	Viti i përfunduar me 31 Dhjetor 2015	(në Euro) Viti i përfunduar me 31 Dhjetor 2014
Edukimi i vazhdueshëm profesional	21,557	10,974
Të drejtat autoriale nga BPP, përkthimi dhe azhurnimi	14,185	9,231
Këshilli dhe komisionet	3,728	9,503
Udhëtimet	11,917	25,806
Takimet vjetore dhe ceremonitë	8,754	7,051
Anëtarësia në organizata	10,821	7,730
Seminare dhe punëtori	3,850	3,430
Pagat – shërbimi për anëtarë	7,233	
Zhvillimi i certifikimeve tjera dhe ke	30,453	
Gjithsej shpenzimet për anëtarë	112,498	73,725

8 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

		(në Euro)
		Me 31 Dhjetor
	2015	2014
Llogari mjedhëse - Pro Credit Bank	266,211	286,363
Llogari mjedhëse - Banka Private Biznesit	126,126	106,129
Llogari mjedhëse - Banka Private Biznesit USD	87	108
Llogari mjedhëse - Banka Ekonomike	108,844	108,864
	501,269	501,464

9 Parapagimet dhe të arkëtueshmet tjera

		(në Euro)
		Me 31 Dhjetor
	2015	2014
Të arkëtueshmet nga anëtarët	3,292	4,593
Të tjera	-	-
Minus: Provisionsi për të arkëtueshmet e këqia dhe të dyshimta nga anëtarët	(329)	(459)
	2,963	4,134

10 Prona, implantet dhe pajisjet

	Kompjuteret dhe pajisjet tjera	Automjeti	Totali
Me 1 Janar 2015			
Kosto	53,463	12,667	66,130
Zhvlertesimi i akumuluar	(47,462)	(9,711)	(57,173)
Vlera neto në libra	6,001	2,956	8,957
Lëvizjet gjatë vitit 2015			
Vlera neto në libra	6,001	2,956	8,957
Shtesat	7,480	-	7,480
Shlyerjet	-	-	-
Zhvlertesimi	(5,528)	(2,533)	(8,061)
Vlera e bartjes	7,953	422	8,375
Me 31 Dhjetor 2015			
Kosto	60,943	12,667	73,610
Zhvlertesimi i akumuluar	(52,990)	(12,244)	(65,234)
Vlera neto në libra	7,953	422	8,375

11 Pasuritë e patrupëzuara

	Me 31 Dhjetor 2015	Me 31 Dhjetor 2014
Me 31 Dhjetor		
Kosto	41,037	41,037
Shtesat gjatë vitit	-	-
Amortizimi i vitit	(230)	(8,208)
Amortizimi i akumuluar	(40,577)	(40,347)
Vlera neto në libra	460	690

12 Detyrimet tregtare dhe të tjera

	(në Euro)	
	Me 31 Dhjetor 2015	Me 31 Dhjetor 2014
Detyrimet për kontributin e tatimit të të ardhurave personale mbi pagat	5,700	7,134
Detyrimet për shërbimet e auditimit	1,195	1,800
Të pagueshme ndaj furnitorëve	5,394	1,784
Të pagueshme ndaj punonjësve	1,651	36
	13,940	10,754

13 Të hyrat e shtyra

Analiza e balancës

Me 31 Dhjetor 2015 dhe 2014, balanca e të hyrave të shtyra përbëhet si në vazhdim:

	(në Euro)	
	Me 31 Dhjetor 2015	Me 31 Dhjetor 2014
Tarifat e shtyra të edukimit	77,668	78,630
Grantet e shtyra:		
- Granti BQK	5,838	5,838
	83,506	84,468

14 Zotimet dhe Kontingjentet

Zotimet

Nuk ka zotime me 31 Dhjetor 2015 përveq marrëveshjes së qerasë së zyrës dhe sallave të trajnimit. Pagesa mujore e qerasë për zyrë dhe sallat të trajnimeve është 2,800 Euro.

Çështjet gjyqësore

Me 31 Dhjetor 2015 nuk është llogaritur asnjë provision për humbjet potenciale në lidhje me çështjet gjyqësore. Menaxhmenti i Organizatës, rregullisht analizon risqet potenciale që rezultojnë nga humbjet në lidhje me proceset gjyqësore dhe pretendimet e mundshme kundër Organizatës, të cilat mund të dalin në të ardhmen. Edhe pse rezultati i këtyre çështjeve nuk mundet gjithmonë të saktësohet, menaxhmenti i Organizatës beson se nuk ka gjasë që të rezultojë ndonjë detyrim material.

15 Ngjarjet pas datës së raportimit

Nuk ka ndonjë ngjarje pas datës së raportimit që kërkon korrëgjim ose shpalosje në pasqyrat financiare.

